

*Doracak për arsimtarë*

---

**H U L U M T I M  
A K S I O N A L N Ë  
P R A K T I K Ë N  
E D U K A T I V O - A R S I M O R E**

---





*Doracak për arsimtarë*

---

**H U L U M T I M  
A K S I O N A L N Ë  
P R A K T I K Ë N  
E D U K A T I V O - A R S I M O R E**

---



DORACAK

Titulli:

HULUMTIM AKSIONAL NË PRAKTIKËN EDUKATIVO-ARSIMORE

Botues: Byroja për Zhvillimin e Arsimit

Për botuesin: mr. Vesna Horvatoviq

Redaktor: mr. Vesna Horvatoviq

Autorë: mr. Gorica Mickovska, Andrijana Tasevska

Bashkëpunëtorë mr. Anica Aleksova, mr. Loreta Georgieva

Përkthimi në gjuhën shqipe: mr. Satki Ismaili

Dizajni: KOMA

Shtypshkronja: Vinsent Grafika

Tirazhi: 200 ekzemplar

ISBN 978-608-206-047-7

CIP - Katalogizacija vo publikacija

Национална и универзитетска библиотека «Св. Климент Охридски», Скопје

371.38.048.2(035)

37.013(035)

MICKOVSKA, Gorica

Hulumtim aksional ne praktiken edukativo-arsimore : doracak /  
[autore Gorica Mickovska, Andrijana Tasevska]. - Shkup : Byroja per  
Zhvillimin e Arsimit, 2015. - 52 str. : илустр. ; 30 см

Библиографија: стр. 40. - Содржи и: Shtojca 1-3

ISBN 978-608-206-047-7

1. Tasevska, Andrijana [автор]

а) Воспитно образовна работа - Практични активности - Прирачници б)

Практична педагогија - Прирачници

COBISS.MK-ID 99388170

Doracaku është i përpiluar me përkahjen finansiare dhe të ekspertëve të  
Zyrës së UNICEF-it, Shkup



Botimi është përgatitur me ndihmën profesionale nga  
Qendra Maqedonase për Arsim Qytetar (QMAQ), Shkup



Qëndrimet e prezantuara në këtë doracak janë të autorëve dhe nuk do të thotë se përputhen me qëndrimet dhe politikat  
e UNICEF-it, Byroja për Zhvillimin e Arsimit (BZHA) dhe Qendra Maqedonase për Arsim Qytetar (QMAQ).

# PËRMBAJTJA

<b>Hyrje .....</b>	<b>5</b>
<b>Hulumtimi aksional.....</b>	<b>7</b>
Pse janë të rëndësishme hulumtimet aksionale?.....	8
Llojet e hulumtimeve aksionale.....	9
Procesi i hulumtimit aksional.....	11
Fazat dhe hapat gjatë planifikimit dhe realizimit të hulumtimit aksional.....	12
Si duket raporti për hulumtimin e realizuar aksional?.....	24
<b>Studimi i rastit.....</b>	<b>27</b>
Fazat dhe hapat te studimi i rastit.....	30
Si duket raporti i studimit të rastit?.....	35
<b>Shtojca 1 .....</b>	<b>41</b>
<b>Shtojca 2 .....</b>	<b>44</b>
<b>Shtojca 3.....</b>	<b>49</b>



# HYRJE



**K**yçja e ndryshimeve dhe inovacioneve në arsim shpesh i bën praktikuesit skeptik në lidhje me nevojën e tyre dhe efektivitetin. Ata më së shpeshti dëshirojnë të kenë përgjigje në pyetjet siç janë: A do të funksionon kjo në shkollën time? Ashtu siç e kam mësuar në trajnim ta zbatoj në praktikë? Çka do të ndodh nëse e bëj modifikimin e ndonjërës nga teknikat? Si punojnë arsimtaërt e tjerë, në shkollat tjera? Nuk i arrijë rezultatet të cilat i pres, çka të bëj? Në shumë pyetje të këtilla, përgjigje mund të fitohen me hulumtime aksionale.

Edhe pse që moti promovohet përmirësimi i praktikës edukativo – arsimore nëpërmjet të hulumtimeve aksionale, ata tek na ende nuk janë gjallëruar. Njëra nga shkaqet e mundshme është që kuadri arsimor dhe profesional në shkolla nuk janë të trajnuar por të realizuar hulumtime aksionale dhe shfrytëzimin e rezultateve të tyre. Shkak tjetër i mundshëm është se nuk ekzistojnë mundësi të mjaftueshme për prezantimin e njohurive nga hulumtimet aksionale. Byroja për zhvillimin e arsimit dhe QMAQ gjatë kohë punojnë në kyçjen e qasjeve inovative në mësimin klasor veçanërisht në ndjekjen e programeve Mendo Matematikisht në klasat fillestare dhe Shkrim – leximi fillestar në klasat fillestare, dhe në vitet e fundit edhe programi Arsimi inkluziv për grupet e rrezikuara. Për t’ju ndihmuar shkollave dhe arsimtarëve në kyçjen e noviteteve dhe promovimin e efekteve që bazohen në hulumtimin e praktikës edukativo – arsimore vetanake, Zyra e UNICEF – it në Shkup inicoi dhe përkrahi përgatitjen e këtij Doracaku dhe organizimin e trajnimeve për realizimin e hulumtimeve aksionale dhe përgatitjen e studimeve të rastit.

Doracaku i është përkushtuar bashkëpunëtorëve profesional dhe arsimtarëve dhe në të shkurtimisht, hap pas hapi është përshkruar procesi i realizimit të hulumtimeve aksionale. Planifikimi i aksioneve inovative, si dhe i aspekteve metodologjike të grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave, nuk janë të përshkruara detajisht, për shkak se supozohet se arsimtarët më janë kompetent për planifikimin e aksioneve inovative, ndërsa bashkëpunëtorët profesional i kanë kompetencat e nevojshme për aspektet metodologjike për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave. Nga kjo, më së miri është në fillim hulumtimet aksionale ti bëjnë në mënyrë ekipore.

Qëllimi përfundimtar është që të përgatitet bazë e hulumtimeve aksionale dhe studimeve të rastit që do ti dokumentojnë praktikën e mira në të tre programet që pritet t’ju ndihmojnë praktikuesve të tjerë për fitimin e përgjigjes të disa sfidave me të cilat ballafaqohen, dhe ti nxitin po të njejtat që ta hulumtojnë praktikën e vet.





# HULUMTIMI AKSIONAL



Hulumtimi aksional është proces në të cilin praktikuesit në mënyrë sistematike hulumtojnë praktikën arsimore vetanake, duke shfrytëzuar teknika hulumtuese dhe refleksion me qëllim që ta kuptojnë, vlerësojnë dhe përmirësojnë të njëjtën.

(Sipas Corey, 1953 dhe Ebbutt, 1985)

**H**ulumtimi aksional është mënyrë e të mësuarit për praktikën vetanake dhe udhëheqës nëpër procesin e të mësuarit dhe zhvillimit të nxënësve. Ai i jep përgjigje pyetjeve: pse, kur dhe si nxënësit mund të mësojnë më mirë. Hulumtimi aksional nuk realizohet mbi njerëzit por me njerëzit, që dotë thotë pjesëmarrje aktive në hulumtim të të gjithë pjesëmarrësve të interesuar.

Karakteristikat	Qëllimet
<ul style="list-style-type: none"><li>» Përqëndrimi është në mësimdhënie dhe në mësimnxënie.</li><li>» Hulumtimin e realizon vetë praktikuesi në lëminë e vetë.</li><li>» Problemi i zgjedhur është nën kontrollin e hulumtuesit.</li><li>» Rezultatet, atij që hulumton, i japin të dhëna për ate se si mundet ta përparon praktikën vetanake.</li><li>» Gjatë realizimit të hulumtimit vazhdimisht shfrytëzohen burime të brendshme dhe të jashtme të të dhënave për tu nxjerrë përfundimet.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>» Përmirësimi i gjendjes në raport me: praktikën vetanake, vehtes si praktikues dhe bashkësinë e vetë.</li><li>» Ndërtim i një bashkësie refleksive dhe kritike e praktikuesve- hulumtues.</li><li>» Zhvillimi i llojeve të ndryshme të diturive dhe shkathtësive te nxënësit dhe të atij që e realizon hulumtimin.</li></ul>

Emri "hulumtim aksional" tregon në ate se bëhet fjalë edhe për hulumtim edhe për aksion. Kjo i lidh të dyjat edhe për ate mund të thuhet se është më shumë se hulumtim i praktikës si dhe më shumë se të menduarit e zakonshëm dhe tentimet për përmirësimin e saj.

Hulumtim aksional NUK ËSHTË ...	Hulumtimi aksional ...
...mendim i zakonshëm për praktikën vetanake.	...paraqet grumbullim sistematik të të dhënave, analizën dhe komentimin e tyre.
...vetëm zgjidhje e problemit nga praktika.	...kyç të kuptuarit e praktikës dhe të mësuarit për ate se si të përmirësohet ajo.
...hulumtim të cilin e bëjnë të tjerët për punën tonë.	...mund t`ju ndihmon edhe të tjerëve që ta përmirësojnë praktikën e tyre.



## PSE JANË TË RËNDËSISHME HULUMTIMET AKSIONALE?

Hulumtimet aksionale paraqesin kombinim të diagnozës, aksionit dhe refleksionit. Ata e "denistifikojnë" dhe demokratizojnë procesin e hulumtimeve shkencore, bëjnë lidhshmërinë e teorisë me praktikën dhe e përmirësojnë të kuptuarit e procesit edukativo-arsimorë. Ata në realitet janë reaktion i vështirësive me të cilat ballafaqohen praktikuesit në tentimet e tyre që njohuritë nga hulumtimet shkencore ti bartin në praktikë, ti zmadhojnë kompetencat dhe autonomitë e arsimtarëve, dhe në të njëjtën kohë të nxësis të mësuarit më të tjerët dhe të mësuarit nga të tjerët.

Me rëndësi është se hulumtimet aksionale përqëndrohen në problemet reale me të cilat ballafaqohen praktikuesit dhe për të cilat vetë mund te gjejnë zgjidhje, dhe se mundësojnë që të kontrollohen ide të reja, mënyra dhe materiale të ndryshme për punë, si dhe të vlerësohet efektiviteti i qasjeve të reja që shfrytëzohen në punë.

Dobi nga hulumtimi aksional ka edhe për ate që hulumton edhe për nxënësit por edhe për shkollën edhe ate:

Për arsimtarin/bashkëpunëtorin profesional	Për nxënësit	Për shkollën
<ul style="list-style-type: none"><li>» Mundësojnë të kuptuarit më të mirë të praktikës vetanake dhe për zhvillimin e saj.</li><li>» Ndryshojnë rolin e arsimtarit duke i dhënë rolin e hulumtuesit.</li><li>» Përmirësojnë shkathtësitë analitike dhe refleksive.</li><li>» Përmirësojnë kompetencat profesionale.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>» Përparojnë procesin e të mësuarit dhe mësimnxënies.</li><li>» Mundësojnë zhvillimin e llojeve të ndryshme të diturive dhe shkathtësive.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>» Nxësin zhvillimin personal dhe profesional.</li><li>» Mundësojnë përparimin e punës edukativo- arsimore.</li><li>» Promovojnë punë ekipore, kolegialitet dhe bashkëpunim.</li></ul>



## LLOJET E HULUMTIMEVE AKSIONALE

Ekzistojnë numër i madh i klasifikimit të hulumtimeve aksionale në raport me karakteristikat e tyre të ndryshme.

### Në raport me përfshirjen:

- 1 \ **Hulumtim individual** – e realizon vetë arsimtari; ndryshimet ndodhin në klasën e tij; kanë të bëjnë me pyetjet për përmirësimin e mësimit të nxënësve dhe përmirësimin të praktikës të arsimtarit. Për shembull: **arsimtari hulumton se si mënyrat e ndryshme të dhënies së informatës kthyesë ndikojnë në suksesin e të mësuarit të matematikës.**
- 2 \ **Hulumtim kolaborativ** – puna e ekipore e arsimtarëve, bashkëpunëtorëve profesional, ekspertëve të jashtëm dhe të interesuarve të tjerë të cilët hulumtojnë problemin e njejtë; ndryshimet ndodhin në një ose më tepër mësojtore dhe kanë të bëjnë me përmirësimin e mësimit dhe mësimit të nxënësve; sigurojnë përmirësim të praktikës mësimore dhe rritje të bashkëpunimit. Për shembull: **arsimtarët e disa lëndëve mësimore punojnë në përmirësimin e të menduarit kreativ dhe së bashku me bashkëpunëtorët profesional zhvillojnë dhe shfrytëzojnë teknika të ndryshme për të menduarit kreativ dhe i ndjekin efektet nga ndryshimet e kyçura.**
- 3 \ **Hulumtim në nivel të shkollës** – ndryshimet i realizojnë më tepër pjesëmarrës; ndodhin në nivel të shkollës; kanë të bëjnë me përmirësimin e pyetjeve me rëndësi për tërë shkollën dhe sigurojnë përparimin e shkollës, zhvillim të bashkëpunimit dhe kolegialitetit. Për shembull: **shkolla në të cilën ka shumë nxënës nga familjet me status të ulët socio-kulturorë dhe ballafaqohen me vështirësi në procesin mësimorë, punon në gjetjen e formave të ndryshme të kyçjes së prindërve në përkrahjen e fëmijëve të tyre në mësim dhe e hulumton efektivitetin e tyre.**
- 4 \ **Hulumtim në nivel të rajonit/shtetit** – ndryshimet i realizojnë më tepër pjesëmarrës-praktikanë dhe ekspert të cilët hulumtojnë problemin e njejtë; kanë të bëjnë me ndërtimin dhe përmirësimin e politikave arsimore dhe sigurojnë bashkëpunim rajonal dhe zhvillim profesional të numrit më të madh të pjesëmarrësve. Për shembull: **Shteti kyç qasje të reja në mësimin e matematikës nëpërmjet "pilotimit" të tyre në shkollë të ndryshme me qëllim që ti identifikon kushtet e nevojshme, barrierat eventuale dhe efektet në të arriturat e nxënësve.**

### Në raport me qasjen hulumtuuese:

- 1 \ **Deskriptive (përshkruese)** – hulumtojnë një grup ( paralele, klasë, arsimtarë në një shkollë) për ti përshkruar dhe analizuar shkaqet për problemin që hulumtohet. Për shembull: **Arsimtari i hulumton dhe i përshkruan vështirësitë me të cilat balafaqohen nxënësit e klasës së parë në fromimin e konceptit për sasi dhe numër.**
- 2 \ **Kuazieksperimentale** – vlerësohen efektet e ndonjë ndryshimi që është kyçur. Për shembull: **Arsimtari i cili ka konstatuar se nxënësit kanë probleme në të shkruarit e përmbajtjeve kreative me shkrim, në një nga paralelet me të cilat punon, kyç qasje të re më të strukturuar për të mësuarit e të shkruarit kreativ, i ndjek efektet në çdonjërën nga fazat dhe i krahason të arriturat me të arriturat e nxënësve në paralelet tjera.**
- 3 \ **Studimi i rastit** – përqëndrohet në një njësi (nxënës, shkollë, dukuri, proces) dhe analizohen shkaqet dhe pasojat. Për shembull: **arsimtari i cili ka konstatuar vështirësi në të mësuarit e leximit të një nxënësi nga klasa e dytë, së bashku me psikologun dhe pedagogun punon në zbulimin e shkaqeve, gjetjen e qasjeve individuale përkatëse dhe ndjekjen e efekteve nga qasjet e zbatuara.**


Hulumtimet aksionale zakonisht nuk janë metodologjikisht të pastra dhe shpesh kombinohen me qasje të ndryshme. Një hulumtim mund të fillon me hulumtim deskriptiv dhe të vazhdon me kuazieksperimental ose mund te fillon si kuazieksperimenatl dhe të purfundon si studim rasti.



## PROCESI I HULUMTIMIT AKSIONAL

Hulumtimi aksional është proces ciklik i cili nuk përfundon me analizën e rezultateve të hulumtimit sikurse të hulumtimet klasike, por fillon me refleksion për praktikën dhe përfundon me refleksion për aksionin e realizuar i cili pastaj shërben si bazë për fillimin e aksionit të sërishëm.

Grafiku 1. Cikli i hulumtimit aksional



Në rast se ai që hulumton vlerëson se është e nevojshme gjatë hulumtimit mund të kryen ndryshime në aktivitetet e planifikuara, të kyç aktivitete të reja dhe ti modifikon ato eksistueset, gjatë së cilës ndryshimet duhet ti shënon në ditarin e hulumtimit. Dy gjëra që janë me kyçe në ciklin e hulumtimit aksional janë:

- 1 \ Sistematizimi në analizën e praktikës vetanake dhe kyçja e ndryshimeve dhe
- 2 \ Procesi i të mësuarit për praktikën vetanake dhe procesi nga ndryshimet e kyçura duhet pasur parasysh nga fillimi deri në mbarim të hulumtimit.



# FAZAT DHE HAPAT GJATË PLANIFIKIMIT DHE REALIZIMIT TË HULUMTIMIT AKSIONAL

Hulumtimi aksional dallohet nga tentimet e përditshme për përmirësimin e praktikave dhe kyçjeve të noviteteve në ta dhe pastaj se ajo është proces i planifikuar dhe se në mënyrë sistematike ndiqen edhe realizimi i aksioneve që ndërmeren dhe efektet nga aksionet e ndërmara. Që të kuptohet me mirë dhe të planifikohet hulumtimi aksional, hulumtuesit kanë identifikuar më tepër faza, gjatë së cilës çdo fazë është treguar nëpërmjet disa hapave .

## **Faza 1** DEFINIMI I LËNDËS SË HULUMTIMIT DHE I PYETJES SË HULUMTIMIT

Në fazën e parë vednosen se çka do të jetë në fokusin e hulumtimit aksional, ashtu që nga problemi i përgjithshëm mjaft i shprehur, arrihet deri te pyetja hulumtuese konkrete. Kjo nuk është rrugë e lehtë, sidomos për fillestarët, për shkak se ju paraqiten shumë probleme që dëshirojnë ti zgjidhin dhe ide për zgjidhje të mundshme. Mirëpo, në rast se nuk arrihet deri në pyetje hulumtuese konkrete dhe të hulumtuar mirë, paraqiten vështirësi të shumta në fazat e mëtejshme nga hulumtimi aksional.



### **Hapi 1 - Identifikimi i problemit**

Identifikimi i problemit fillon me refleksion të brendshëm. Me qëllim të caktohet fokusi i hulumtimit, është e nevojshme të mendohet për praktikën vetanake, për ndonjë situatë të rëndësishme gjatë punës me nxënësit ose për ndonjë ndryshim të kyçur (program i ri, metoda mësimore, teknika) për të cilat dëshirojmë ta shohim ndikimin e tij ndaj nxënësve.

Në fillim nga të gjitha pyetjet, idetë, lëmitë që do të shfletohen, është e nevojshme të selektohet ajo që i plotëson kriteret për pyetje hulumtuese të formuluar mirë:

Pyetja hulumtuese e formuluar mirë:

- » Ka të bëjë me mësimdhënien dhe mësimnxënien;
- » Mund të jetë nën kontrollin e atij që hulumton;
- » Është diçka që dëshirojmë ta ndryshojmë ose përmirësojmë;
- » Ndryshimin të cilin e presim mundemi ta matim p.sh. me test, pyetësor, vëzhgim;
- » Ndryshimin mund ta bëjmë në kohë reale;
- » Shkakton interesim të fortë te hulumtuesi – për shkak se dëshiron ta ndryshon situatën e tillë.



Pse  
ndodh...?



Si ta  
kërkoj...?

Çka do të ndodh  
në rast se ...?



Si do të  
ndryshon...?



Në këtë hap mund të jetë e vlefshme biseda me kolegët, për shkak se edhe ata mund të kenë problem të njëjtë ose të ngjashëm dhe ndoshta do të vendosni që të realizoni hulumtim aksional të përbashkët që mund ta lehtëson punën dhe të ndikon në kualitetin e hulumtimit.



## Hapi 2 - Formulimi i pyetjes së hulumtimit

Pyetja e mirë hulumtuese është e liruar nga zhargoni arsimor.

Në te shfrytëzohen fjalë të rëndomta, të përditshme të cilat qëllimin e bëjnë të qartë për secilin.

Në pyetjen hulumtuese nuk parashikohen rezultatet

Duke patur parasysh ate se hulumtimi aksional në realitet na ndihmon që ti kuptojmë pasojat nga aksioni i ynë, gjegjësisht nga ndryshimet që i kyçin, pjesa më e vështirë e dizajnit të hulumtimit aksional është formulimi i mirë i pyetjes hulumtuese.

На почетокот составете листа од прашања и подрачја во кои се планира да се интервенира.



Si  
të përparohet  
bashkëpunimi ndërmjet  
nxënësve nëpërmjet të  
zbatimit të mësuarit  
ekspor?



Si  
ndikojnë strategjitë e të  
mësuarit ndaj punës  
së nxënësve?



Si  
duhet të përdorin  
informatat  
nxënësit në situata të  
reja?

Në fillim formuloni listë me pyetje dhe lëmi në të cilët planifikohet të intervenohet. Mirë është që të fillohet me pyetjen: „Çka do të ndodhte nëse ...“

- Zgjidhni një pyetje nga lista e pyetje
- Pyetni veten pse kjo pyetje është interesante për Ju, në cilën mënyrë do të vini deri në përgjigjen e pyetjes dhe çka paraqet përgjigja e pyetjes për praktikën tuaj.

Formulimet fillestare të pyetjes hulumtuese zakonisht janë më të përgjithësuar. Për tu konkretizuar pyetja hulumtuese, duke kyçur në të edhe aksionin që do të ndërmerret, është e nevojshme që të bëhet hulumtimi i literaturës dhe përvojat e të tjerëve që kanë patur problem të njëjtë. Në atë mënyrë arrihet deri te ideja për ate se si mundet që të zgjidhet problemi me nxënësit, në klasë ose në shkollë. Pastaj shënoni versionin e parë të pyetjes dhe shpërndani ate me kolegët dhe dëgjoni mendimin e tyre.

Kur do të përqëndroheni në një pyetje, ajo që vijon është: Çka do të bëj në lidhje me ate? Pyetni vehten se a mund të bëni diçka relativisht të zakonshme që do t'ju mundëson nxënësve të mësojnë më mirë, që të fitojnë shkathtësi përkatëse etj. Nëse dëshironi të dini edhe diçka tjetër, para se të ndërmerni aksionin, bisedoni edhe me nxënësit për ate se çka mendojnë, për ate se si mësojnë dhe sa kanë mësuar. Bëni listën me idetë e mundshme për përmirësimin e gjendjes dhe zgjidhni një që do ta provoni. Për ta bërë ate, do të duhet të formuloni paramendim për shkakun e mundshëm për problemin dhe zgjidhjen e mundëshme. Zgjidhjen që do ta zgjedhni duhet të realizohet. Paralelisht me këtë mendoni se si do ta matni suksesshmërinë e aksionit të ndërmarë.

- **Riformuloni pyetjen – bëni që të jetë konkrete dhe hulumtuese.**
- **Pyetja le ta përmban efektin e dëshiruar, popullacionin për të cilin bëhet fjalë, përmbajtjen e aksionit të cilën duhet ta realizojmë.**

#### Shembull për riformulimin e pyetjes:

Versioni i parë i pyetjes	Versioni i dytë i pyetjes	Riformulimi i pyetjes për të qenë hulumtuese
Pse disa nxënës sillen pa durim dhe ofendojnë njëri tjetrin?	Si t'ju ndihmoj nxënësve të mi të ndërtojnë klimë respekti në klasë?	A do të ndikon organizimi i një serie të puntorive për zhvillimin e respektit nëpërmjet të lojës së roleve në zvogëlimin e ofendimeve ndërmjet nxënësve nga klasa e pestë dy?
<p>» Pyetja nuk e përmban efektin e pritur, as përmbajtjen e aksionit.</p> <p>» Nuk është caktuar saktë popullacioni – <i>disa nxënës</i>.</p> <p>Kjo pyetje në realitet shërben për detektimin e problemit.</p>	<p>» Në pyetje është dhënë efekti i pritur – <i>ndërtimi i klimës së respektit në klasë</i>, por në mënyrë të përgjithësuar.</p> <p>» Popullacioni është më konkret – <i>nxënësit e mi</i>.</p> <p>» Nuk është kyçur përmbajtja e aksionit.</p> <p>Pyetja në realitet shpjen në kërkesen për aksion me të cilën do të arrijmë efektin e kërkuar.</p>	<p>» është dhënë efekti i pritur dhe ai është përshkruar konkretisht – <i>zvogëlimi i jotolerancës dhe ofendimeve ndërmjet nxënësve</i>.</p> <p>» Popullacioni është caktuar konkretisht – <i>nxënësit e klases pesta dy</i>.</p> <p>» është caktuar përmbajtja e aksionit – <i>seri e puntorive për zhvillimin e respektit nëpërmjet të luajtes së roleve</i>.</p> <p>Nga formulimi i këtillë i pyetjes shikojmë se me kënd do të bëjnë ndryshime, si do ti bëjmë dhe çka presim të arrijmë (pse i bëjmë ndryshimet)</p>



Kontrolloni se pyetja e juaj hulumtuese a i plotëson kërkesat për pyetje hulumtuese të mirë. Në rast se nuk i plotëson, mendoni për kërkesën që nuk është kënaqur dhe përsëri riformuloni pyetjen.

### Shembull nga Faza 1

#### Pyetje hulumtuese e formuluar

Hulumtim individual i arsimtarit	Hulumtiv kolaborativ
Cila infomatë kthye në mësimin e matematikës për nxënësit e klasës së gjashtë është më efektive – me shkrim ose gojore?	Si të shfrytëzohen teknikat kreativenë mësim në lëndë të ndryshme me qëllim që të ndikohet në nxitjen e kreativitetit të nxënësit e klasës së katërt?

## Faza 2 PLANIFIKIMI I HULUMTIMIT

Hapat të cilat janë përshkruar në Fazën 2, në realitet janë elementet nga të cilat përbëhet *plani aksional* në bazë të së cilit, pastaj, do të realizohet hulumtimi aksional. Me rëndësi është se ky plan aksional është fleksibil, në realitet mund të ndryshohet dhe plotësohet.



### Hapi 3 - Caktimi i strategjisë e cila do të shfrytëzohet

#### 1 \ Caktimi i aktiviteteve konkrete të nevojshme për zgjidhjen e problemit

- Shfletoni aspektet e problemit.
- Identifikoni strategjitë për zgjidhjen e secilit aspekt të problemit.
- Krahasoni dhe diskutoni me kolegët zgjidhjet alternative.
- Caktoni strategjinë më të mirë.

Në rast se punohet për hulumtim kolaborativ, me rëndësi është të sigurohet pjesëmarrje e të gjithëve që do të kyçen dhe të sigurohet mirëkuptim i përbashkët për mënyrën se si planifikohet zgjidhja e problemit.

#### 2 \ Përshkrimi i aktiviteteve

Përshkruani në mënyrë të detajuar aktivitetet që planifikoni ti realizoni. Sa që janë të menduara paraprakisht në detaje, aq më lehtë është realizimi i procesit. Më vonë, në rast se vini në dijeni se duhet diçka të ndryshoni, mund ta bëni atë. Të gjitha ndryshimet dhe shkaqet për ndryshime duhet që të shënohen.



## Hapi 4 – Identifikimi dhe sigurimi i resurseve të nevojshme

Që të mundet aksioni i planifikuar të realizohet me sukses, me rëndësi është që të sigurohen resurset e nevojshme..

Mendoni në kahjet vijuese:

- Çka ju nevojitet për ta zgjidhur problemin me shfrytëzim të strategjisë së zgjedhur?
- Cilat resurse i keni në disponim dhe cilat plotësisht duhet ti siguroni?
  - » Materiale.
  - » Informata.
  - » Ndhmë.
- Mendoni si dhe kurrë do ti siguroni resurset të cilat nuk i keni.
- Siguroni se gjithçka ju nevojitet do ta keni në dispozicion atëherë kur do t'ju duhet.
- Nëse është e nevojshme, planifikoni kurrë dhe nga kush do t'ju duhet ndihmë.

Të gjithë këte shenoni në planin e hulumtimit.



## Hapi 5 – Identifikimi i pengesave

Gjatë hulumtimit aksional, praktikuesit shpesh ballafaqohen me pengesa të ndryshme, dhe me rëndësi është që këto pengesa të identifikohen me kohë.

Pyetni vehten:

- A ka pengesa për realizim të suksesshëm të hulumtimit?
- A munden që në fillim të parashikojë se çka do të bëjnë nëse paraqiten?

Edhe pse vështirë është që të parashikohen të gjitha gjërat që mund të ndikojnë negativisht ndaj hulumtimit aksional të suksesshëm, mirë është që të parashikohen sa më shumë nga ta. Nëse pengesat janë të pakalueshme, duhet të kërkoni zgjidhje tjetër të problemit dhe të riktheheni përsëri në procesin e planifikimit- të filloni sërish.



## Hapi 6 – Matja e suksesshmërisë/grumbullimi dhe rregullimi i të dhënave

Ajo që ndër të tjera e dallon hulumtimin aksional nga tentimet e përditshme për përmirësimin e praktikës është matja e suksesshmërisë së aksionit të ndërmarë.

Duhet të dini se si do të vlerësoni se aktivitetet e ndërmara ju kanë shpjerë deri në sukses. Për ate që në fillim duhet të caktohet se çka llogaritet për sukses, si do të bëhet matja e saj dhe si dotë llogaritet se është aritur sukses (cilat vlera/ procedurat/ vlerat e asaj se çka matet do të tregojnë/ do të komentohen si sukses i kënaqshëm).

Grumbullimi sistematik i të dhënave është kyçe për matjen e suksesshmërisë.

## 1 \ Grumbullimi i të dhënave

- Në fillim caktoni se çfarë të dhëna do t'ju nevojiten.
- Pastaj caktoni se nga kush do ti merrni dhe se si do ti siguronit të dhënat.
- Mendoni se cilat të dhëna natyrisht i keni në disponim dhe kanë të bëjnë me hulumtimin tuaj.
- Për çdo grup ose lloj të të dhënave, caktoni se në cilën periudhë duhet ti siguronit – në fillim – gjatë rrjedhës – në fund të hulumtimit.

Për aksionet hulumtuese është karakteristike ajo që të dhënat grumbullohen në kontinuitet dhe se përdoren:

- Që të fitohet pasqyrë për situatën ekzistuese;
- Që të planifikohen ndryshimet që dëshirojmë ti kyçim;
- Të sillen vendime për ndryshimin e ndryshimeve dhe kyçjen e të tjerave dhe
- Që të konstatohen efektet nga të gjitha ndryshimet e kyçura.

Domethënë, të dhënat grumbullohen para se të fillon hulumtimi, gjatë kohës së hulumtimit dhe në fund të aksionit..

### Grumbullimi i të dhënave para se të fillon hulumtimi

Në fillim të hulumtimit grumbullohen:

- Të dhëna për gjendje të cilat dëshirojmë ti ndryshojmë – japin përgjigje pyetjes: si do të vërtetoj se gjendja është e tillë që kërkon ndryshime ose është i nevojshëm ndryshimi?
- Informata për atë se çka tregojnë teoria dhe hulumtimet tjera për këtë problem (pasqyrë e literaturës relevante), që japin përgjigje në pyetjen: A ka bazë profesionale ndryshimi i planifikuar?

Mund të shfrytëzoni të dhëna të cilat veç më i keni fituar ose plotësisht të grumbulloni të dhëna. Mund ti shfrytëzoni të gjitha mënyrat të cilat zakonisht shfrytëzohen në hulumtime: anketa, intervista, teste, fotografi, sociograme, shënime anekdotike, shembuj nga punimet e nxënësve, opservime, videoshënime dhe të dhëna t'jera përkatëse.

Zgjedhni disa mënyra të cilat do të mundeni ti zbatoni relativisht lehtë, aq që do tju sigurojnë të dhëna që do të jenë relevante

### Shembull:

#### Hulumtim individual

- » Suksesi i nxënësve para dhënies së serisë së informatave kthyese
- » Pyetësor për nxënësit
- » Pyetësor për prindët

#### Hulumtim kolaborativ

- » Pyetësor për nxënësit
- » Analiza e punimeve të nxënësve
- » Test kreativiteti

## Grumbullimi i të dhënave gjatë kohës së hulumtimit

Grumbullimi i të dhënave gjatë hulumtimit duhet të jep përgjigje në pyetjen: si do të vërtetoni se cilat aktivitete i keni ndërmarrë dhe cilat ndryshime i keni kyçur? Në këtë fazë zakonisht shfrytëzohen:

- Shënime për sjelljen e nxënësve, reagimet e tyre dhe përparimi:
  - » Shënime për ndikimet negative dhe pozitive,
  - » Shënime anekdotike,
  - » Ditari personal reflektiv.
- BVideoshënime dhe audioshënime për:
  - » Aktivitete e arsimit,
  - » Aktivitetet dhe reagimet e nxënësve.

### Shembull:

Hulumtim individual	Hulumtim kolaborativ
<ul style="list-style-type: none"><li>» Ndjekje e aktiviteteve të nxënësve</li><li>» shënime anekdotike</li><li>» të vërejturit të aspekteve pozitive dhe negative nga ndryshimi</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>» opservim</li><li>» fotografi</li><li>» analizë e punimeve të nxënësve</li><li>» të vërejturit i aspekteve pozitive dhe negative nga ndryshimi</li></ul>

## Grumbullimi i të dhënave në fund të aksionit

Grumbullimi i të dhënave në fund të hulumtimit duhet ti jep përgjigje pyetjes: si janë efektet nga ndryshimi i kyçur?

Në disponim janë të dhënat të cilat zakonisht grumbullohen por shpesh është e nevojshme që të bëni hulumtime dhe matje plotësuese. Racionale është nëse mund të shfrytëzohet një pjesë nga instrumentet me të cilat janë grumbulluar të dhëna në fillim të hulumtimit. Keni parasysh gjatë planifikimit se cilat dhe çfarë të dhëna do të grumbulloni.

Mund të shfrytëzohen qasjet vijuese dhe burimet e të dhënave:

- Post-testim/vlerësim postformal. (Për matjen e të ariturave të nxënësve pas ndërhyrjes/aksionit ka përfunduar.)
- Bisedë/ intervistë me nxënësit. (Për sigurimin e të dhënave plotësuese për të arriturat, qëndrimet, përvojat.)
- Portfolitë e nxënësve. (Që të shikohet kualiteti i të ariturave të tyre, përparimi që kanë bërë.)
- Kontrollimi i videoshënimeve. (Të evaluohet ndryshimi i sjelljes, strategjitë e zbatuara.)
- Vetëvlerësim. (I efektivitetit të planifikimit, arritjes të qëllimeve.)

## Shembull

Hulumtim individual	Hulumtim kolaborativ
<ul style="list-style-type: none"> <li>» Suksesi i nxënësve para dhënies së serisë së informatave kthyese</li> <li>» Pyetësor për nxënësit</li> <li>» Pyetësor për prindët</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Pyetësor për nxënësit</li> <li>» Fleta evaluimi</li> <li>» Fotografi/videoshënime</li> <li>» Analizë e punimeve të nxënësve</li> <li>» Test kreativiteti</li> </ul>

## 2 \ Rregullimi i të dhënave

Në fazën e planifikimit, planifikohet edhe mënyra e rregullimit të të dhënave. Planifikimi i këtillë mund të ndihmon edhe për caktimin më të mirë e asaj se cilat dhe çfarë të dhënash do të grumbullohen, si dhe cilat instrumente do të duhet të përgatiten.

Mund të shfrytëzoni mënyra të ndryshme të rregullimit të të dhënave:

- Grafike, tabela, grupim të përshkrimeve kualitative;
- Analizë komparative e të dhënave/ informatat nga hulumtimet/ literatura..

Planifikoni të shfrytëzoni të dhëna më së paku nga tre burime – parimi i triangulacionit, dhe përgatitni shablon triangulacioni.

## Shembull

### Shablони triangulativ

Pyetja hulumtuese	Burimi i të dhënave 1	Burimi i të dhënave 2	Burimi i të dhënave 3
Cila informatë kthyese është më efektive në mësimin e matematikës – me shkrim ose me gojë?	Evidenca për suksesin e nxënësve	Punime të nxënësve	Anketa me nxënës dhe prind
Si ndikon në kreativitetin e nxënësve shfrytëzimi i teknikave kreative në mësim në lëndë të ndryshme?	Pyetësor dhe fleta evaluimi	Fotografi dhe videoshënime	Punime të nxënësve



## Hapi 7 - Planifikimi i kohës

Pasi që keni zgjedhur strategji adekuate për zgjidhjen e problemit dhe keni zhvilluar strategji për grumbullimin e të dhënave, duhet të bëhet plan për realizimin e aktiviteteve të caktuara.

- Planifikoni se sa do të zgjat aktiviteti përkatës.
- Kur realisht duhet të realizohet aktiviteti i planifikuar.
- Për ta lehtësuar punën, shfrytëzoni versione elektronike të thjeshta për planifikim (në Ekscel (Excel), Vord (Word), Pauer point (Power point)).

## Faza 3 KRAHASIMI I HULUMTIMIT



### Hapi 8 – Matjet fillestare

Para se të fillon realizimi i planit, në realitet shfrytëzimi i strategisë për zgjidhjen e problemit ose përmirësimin të mësimin, shpesh është e nevojshme që të bëhen disa hulumtime të gjendjes fillestare. Kjo është me rëndësi, zakonisht të hulumtimet kuazieksperimentale ku dëshirojmë të bëjmë krahasimin e gjendjes në fillim dhe në fund të aksionit të planifikuar. Matja fillestare mund të përfshinë edhe matje të disa variablave në të cilat nuk dëshirojmë/ nuk mundemi të ndikojmë, por mundet të ndryshohen me kalimin e kohës dhe më vonë të ndikojnë në rezultatet nga aksionet e ndërmarra (si p.sh. gjendja familjare).

- Bëni matjet fillestare, në rast se i keni planifikuar.
- Keni kujdes, në rast se është e mundur, të dhënat që do të fitohen të jenë të krahasueshme me të dhënat nga matjet që keni planifikuar që ti bëni në fund.

Në matjet fillestare është e dobishme që të kyçen edhe persona tjerë të pavarur, sidomos në vëzhgim, për shkak se ata mundet me qenë më objektiv.



### Hapi 9 – Krahasimi i aktiviteteve të planifikuara

Pasi që ta bëni matjen fillestare, mund të filloni me realizimin e ndryshimit që keni planifikuar me grupin e personave që hulumtohen, në realitet të situatës që e keni zgjedhur. Me rëndësi është që aktiviteti i planifikuar të zgjasë mjaft gjatë, për shkak se në arsim ka pak strategji që japin efekt në afat të shkurtë.

Gjatë kohës së realizimit të aktiviteteve:

- Shënoni të gjitha sjelljet relevante/ të arriturat gjatë aktiviteteve.
- Në rast se ka nevojë ti ndryshoni aktivitetet, bëni ato, por merrni shënime pse i keni bërë ndryshimet dhe çfarë efektesh do të ketë ai ndryshim.

Pasi që të përfundoni me realizimin e aktiviteteve:

- Matni efektet ashtu siç keni planifikuar. Shfrytëzoni burime të ndryshme të diturive - triangulacioni.
- Nëse është e arsyeshme, shfrytëzoni instrumente të njejta sikurse në matjen fillestare.
- Bëni vetëvlerësimi të procesit të realizimit të hulumtimit dhe të mësimin vetanak.
- Kyçni në proces **shokun kritik**. Ai është kolegu ose dikush i cili është i aftësuar ta kritikon punën tuaj dhe t'ju ndihmon që ta shikoni në një këndvështrim tjetër. Kritika është e domosdoshme dhe ndihmon që të bëjmë vlerësim të kualitetit të hulumtimit tonë.

## Faza 4 PËRPUNIMI I TË DHËNAVE DHE PREZANTIMI I RREZULTATEVE



### Hapi 10 – Analiza dhe interpretimi i rezultateve

Që të vërtetohet se aksioni / aktiviteti / strategjia e ndërmarrë ka qenë e suksesshme, është e nevojshme që të analizohen të dhënat që janë grumbulluar dhe të interpretohet rëndësia e tyre. Analiza e të dhënave duhet t'ju jep përgjigje pyetjeve: Çka na tregojnë të dhënat në raport me pyetjen hulumtuese? Sa jemi të sigurtë në përgjigjen në të cilën na shpiejnë të dhënat? Varësisht nga rëndësia e rezultateve do të vendosni se a do të bëni ndryshime në praktikën tuaj.

Kur do ti grumbulloni të dhënat, duhet ti kontrollni (a ka gjithçka, a duhet edhe diçka të merret) dhe ti organizoni për përpunimin e tyre. Të dhënat kualitative mundet më lehtë ti përpunoni p.sh. në Word sipas fjalëve kyçe.

Më së shpeshti është e nevojshme që të krahasohen dhe të vërtetohen ndryshimet:

- Ndërmjet gjendjes fillestare dhe përfundimtare,
- Tek grupet e ndryshme..

Procesi i triangulacionit ndihmon që të krahasohen të dhënat e fituara nga burimet e ndryshme dhe të vërtetohet besueshmëria e tyre. Nëse të gjitha burimet e të dhënave janë të besueshme, atëherë mundet pyetjeve të parashtruara t'ju përgjigjeni me shkallë të lartë të sigurisë. Në rast se ekziston papajtueshmëri ndërmjet rrezultateve të fituara nga të tre instrumentet, atëherë zvogëlohet shkalla e sigursë së përgjigjes/ përfundimit.

Një pjesë e të dhënave që do ti fitoni janë kuantitative dhe për përpunimin e tyre më së miri është që të shfrytëzohet ndonjë programë kompjuterike – si psh. Excel, SPSS. Për përpunimin e tyre është e nevojshme që të zgjidhet modeli statistikor për analiza të dallimeve (meset aritmetike, korelacionet, analiza e variacionit).

Pjesa tjetër e të dhënave janë kualitative dhe në analizën e tyre është kyçur leximi kritik, kërkimi i lidhjeve ndërmjet të dhënave, nxjerrja e përfundimeve dhe vendosja e tyre në aspekte të caktuara të problemit i cili hulumtohet. Këti procesi i paraprinë rregullimi i të dhënave në atë mënyrë që një pjesë e tyre do të mundet të vendosen në kategoritë që do të munden pastaj të përpunohen në mënyrë kuantitative (ndonjëherë edhe pa përdorim të pakove statistikore – nëpërmjet të mbledhjes në tabela ose në paraqitje grafike), ndërsa një pjesë do të prezantohen në mënyrë holistike me potencim të informatave të rëndësishme.

Kur do ti fitoni të dhënat statistikore, pyetjet që duhet të parashtrihen janë:

- Çka tregojnë të dhënat e fituara?
- Çka zbuluat?
- A u vërtetuan parashikimet të cilat i kishit në fillim?

Hulumtimet aksionale realizohen me qëllim që të sigurohen të dhëna të cilat do të shfrytëzohen për përmirësimin e praktikës. Për atë në bazë të inetrpretimit duhet ti jepni përgjigje pyetjeve: Në bazë të asaj që e kuptova nga hulumtimi çka do të bëj ngjajshëm në të ardhshmen, a çka ndryshe?



## Hapi 11 – Ndryshimi i praktikës

Qëllim kryesor i humutimit aksional është që në bazë të rezultateve të aftësohet ose të ndryshohet praktika / gjendja me të cilën më parë nuk keni qenë të kënaqur. Në bazë të njohurive nga hulumtimi mund:

- Të jepen propozime për zgjidhjen e problemit;
- Të sjellen vendime dhe të planifikohet se çka do të ndërmerret më tutje;
- Të bëhen plane aksionale / operative për aktivitetet e mëtutjeshme.



## Hapi 12 – Refleksioni

Refleksioni paraqet pjesën më të rëndësishme nga procesi *i hulumtimit aksional*. Në realitet, *hulumtimi aksional fillon dhe përfundon me refleksion*. Refleksioni realizohet edhe gjatë tërë procesit të aksionit dhe ai shpjen nga aksioni i ri. Refleksioni paraqet vlerësim të saktë dhe të sigurtë për atë se Çka kemi bërë, por edhe vlerësim të asaj në çfarë probleme kemi hasur, çka ka mundur të bëhet ndryshe, ku janë dobësitë dhe çka do të duhej të ndryshohet në të ardhmen. Ai duhet ti jep përgjigje pyetjeve vijuese:

- A fitova përgjigje të pyetjes hulumtuese?
- A kisha të dhëna të mjaftueshme për të nxjerrë përfundime thelbësore? Çka do të bëj herën tjetër ndryshe?
- A është e nevojshme që të bëhen ndryshime në proces ose të përmirësohen instrumentet?
- A u paraqitën pyetje të reja gjatë hulumtimit ose u paraqitën në bazë të njohurive të fituara?
- A ishin të gjithë pjesëmarrësit të kyçur dhe a bashkëpunonin?
- A ndikoi hulumtimi për të menduarit e thellësishëm për praktikën vetanake?
- A ndikoi hulumtimi për ndryshime pozitive te pjesëmarrësit të kyçur në hulumtimin aksional?
- A solli hulumtimi ndryshimet e dëshiruara, zgjidhje të problemit?
- Çka të bëni tjetër?





## Hapi 13 – Prezantimi

Hulumtimi aksional paraqet mundësi që të tjerët të mësojnë nga praktika jonë. Nëpërmjet të shkëmbimit të përvojës sonë ndikojmë në zhvillimin profesional personal, por edhe për zhvillimin a praktikantëve të tjerë. Arsimatrët më së shumti dëshirojnë të mësojnë nga praktika e të tjerëve, veçanërisht nëse ajo është e vërtetuar me fakte për efikasitet. Njohuritë nga hulumtimi aksional mund të prezantohen në mënyra të ndryshme.

- **Diseminimi para kolegëve në shkollë ose në ekipet rajonale/bashkësi për mësim.** Kjo do të duhej të jetë niveli i parë dhe bazik i diseminimit. Zakonisht në këto takime ka më tepër kohë për prezantim të rrezultateve dhe për diskutimin e tyre. Për kolegët është e mjaftueshme që të përgatitni prezantim Power point me pjesë të fakteve kyçe për praktikën.
- **Shpallja e revistës profesionale.** Kur shënohet punim për shpallje, duhet patur parasysh se nuk ekziston mundësia që të jepen sqarime plotësuese, dhe për atë punimi duhet qartë të paraqet: problemin, aktivitetet e ndërmarra, mënyrat e matjes, rrezultatet e fituara dhe përfundimet. Madhësia e punimit varet nga natyra / kërkesat ose rregullat e revistës, ku dëshironi që ta publikoni. Stili, gjithashtu , varet nga karakteri i revistës.
- **Prezantimi i ngjarjes profesionale.** Zakonisht, organizatorët e ngjarjeve profesionale (konferenca, kongrese, simpoziume,etj.) japin kahje në lidhje me madhësinë dhe mënyrën e prezantimit të punimit. Duhet të ndiqen kahjet e dhëna, por edhe ajo se në cilën mënyrë ju do ta prezantoni punimin tuaj (në mënyrë plenare, në seksione, punëtori, poster, etj.).
- **Shpallja në bllogun personal, web-faqe ose fejsbuk.** Kjo është mënyra më e thjeshtë që njohuritë e juaja ti bëni të kapshme për publikun më të gjërë profesional për shkak se varet vetëm nga ju ( nuk ka nevojë që dikush të japë leje). Megjithatë, kjo nuk e zvogëlon përgjegjësinë që në mënyrë profesionale ti paraqitni njohuritë e juaja me të gjitha rezervat që keni (nëse ka të tilla).
- **Shpallja në web-faqen oficiale të institucionit arsimor** (p.sh. BZHA, MASH). Gjatë publikimit në Web – faqet oficiale, zakonisht vlejné rregullat e njejtá sikurse gjatë publikimi të punimit në revista profesionale.

Pa dallim se në çfarë mënyre do ti prezantoni njohuritë e juaja, do të jetë e nevojshme nëse atë që e keni përgatitur për prezantim ta shpërndani në disa nga kolegët e juaj dhe ti lutni ata ta lexojnë në mënyrë kritike dhe tu japin këshilla se çka mund të përmirësoni.



## SI DUKET RAPORTI PËR HULUMTIMIN E REALIZUAR AKSIONAL?

Materiali nga hulumtimi aksional i realizuar duhet të jetë i organizuar mirë dhe i përshkruar në raportin që të mundet të shpërndalet me të tjerët, në realitet të prezantohet. Në raport duhet veçanërisht në detaje të përshkruhet procesi i realizimit të hulumtimit aksional edhe ate:

- Të përshkruhen ndryshimet që kanë ndodhur gjatë kohës së hulumtimit,
- Çka është kyçur në mënyrë plotëseuse, dhe çka është ajo që është ndryshuar si pasojë e kyçjes së diçka të re ose ndryshim i praktikës ekzistuese,
- Të përshkruhen vështirësitë me të cilat janë ballafaquar dhe si janë tejkaluar ata,
- Çka është ajo që e kemi mësuar,
- Si do ta ndryshon praktikën tonë ky hulumtim dhe çka do të vijon më tutje.

Megjithate në raport nuk mjafton vetëm të përshkruhen aktivitetet dhe procedurat me të cilat janë realizuar, por është edhe me më rëndësi që të jepet vështrim e asaj diturie të re, në realitet leksione të reja që kanë dalur nga ai hulumtim.

**Struktura e raportit** për hulumtimin aksional të realizuar mund të jetë me sa vijon:

### Hyrje:

- Cila është pyetja hulumtuese?
- Pse kjo pyetje është me rëndësi për mua ? Cilat janë qëllimet e këtij hulumtimi?
- Cili është konteksti i këtij hulumtimi?
- Çka tregojnë të dhënat nga matjet fillestare?

### Njohuri të fituara nga literature:

- Çka mësova për lëndën e hulumtimit tim?
- Si janë përvojat e të tjerëve?
- Si kemi arritur deri te strategjia për tejkalimit e problemit?

### Metodologjia:

- Si është plani aksional i hulumtimit tim?
- Cilin ndryshim e kam kyçur?
- Si e kyça ndryshimin?
- Cilat metoda të hulumtimit i kam përdorur?

**Rezultatet dhe përfundimet:**

- Grumbullimi dhe prezantimi i rezultateve
- Diskutim në lidhje me rezultatet dhe përfundime

**Implikacionet dhe sygjerimet:**

- *Çka mësova nga ky hulumtimi im?*
- *Çka do të bëj më tutje?*
- *Informatat të cilat i fitova si do të mundet që të shfrytëzohen nga të tjerët?*
- *Në rast se ë përsëris hulumtimin, çka do të bëja ndryshe?*

**Shtojca:****Rekomandime.**

Pasi që njëherë të shkruani një raport të këtillë, pastaj lehtë mund ta shfrytëzoni për qëllime dhe mënyra të ndryshme të prezantimit.

**Shembuj nga raportet e hulumtimeve aksionale**

Në dy shembujt vijues të hulumtimeve aksionale janë përshkruar ata hapa të cilat janë pjesë të Fazës 2, në realitet janë pjesë të planit aksional për realizimin e hulumtimit.

(Janë shfrytëzuar hulumtime aksionale nga publikimet Vlerësimi për mësim në shekullin 21, USAID, AED, QMAQ, Shkup, 2010; dhe punimi "Teknikat kreative në mësimin klasor", A.Ivosheviq, Fakulteti filozofik, Osijek, 2013)..

	Hulumtim individual	Hulumtim kolaborativ
<b>Hapi 1</b> -Identifikimi i problemit	Pas trajnimit për vlerësimin formativ është konstatuar se informata kthyesë me shkrim nuk shfrytëzohet aq sa duhet.	Në shkollë dominon mendimi së nxitja e kreativitetit të nxënësit nëpërmjet mësimin mund të realizohet vetëm në disa lëmi të caktuara mësimore (arsim figurativ dhe muzikorë, gjuhë amtare), ndërsa në të tjerat ajo është e vështirë ose e pa mundur.
<b>Hapi 2</b> - Formulimi i pyetjes hulumtuese	Cila informata kthyesë në mësimin e matematikës për nxënësit e klasës së gjashtë është më efektive – me shkrim ose gojore?	Si të shfrytëzohen teknikat kreative në mësim në lëndët e ndryshme me qëllim që të ndikohet në nxitjen e kreativitetit të nxënësit e klasës së katërt ?

<p>Hapi 3 - Caktimi i strategjisë e cila do të shfrytëzohet</p>	<p>Dhënia e informates me shkrim dhe me gojë në orët e matematikës. Ndjekja e përparimit të nxënësve dhe kualiteti i punës së tyre. Nxënësit nga klasa e gjashtë.</p>	<p>Kyçja e teknikave kreative nëpërmjet 16 aktiviteteve në mësim në lëndë të ndryshme dhe integrim të përmbajtjeve nga lëndët e ndryshme. Analiza e punimeve të nxënësve. Nxënësit e klasës së katërt.</p>
<p>Hapi 4 - Identifikimi dhe sigurimi i resurseve të nevojshme</p>	<p>Nuk janë të nevojshme resurse plotësuese.</p>	<p>Vizatime, ngjyra, gjësende, kube, instrumente muzikore, kollazh, letër.</p>
<p>Hapi 6 - Matja e suksesshmërisë - grumbullimi dhe rregullimi i të dhënave</p>		
<p>Para se të fillon hulumtimi</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Suksesi i nxënësve para dhënies së serisë së informatave kthyese.</li> <li>» Pyetësor për nxënësit.</li> <li>» Pyetësor për prindërit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Pyetësor për nxënësit.</li> <li>» Analizë e punimeve të nxënësve.</li> <li>» Test kreativiteti.</li> </ul>
<p>Gjatë kohës së hulumtimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Ndjekja e aktiviteteve të nxënësve.</li> <li>» Shënime anekdotike.</li> <li>» Vështrimi e aspekteve pozitive dhe negative nga ndryshimi.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Opservim.</li> <li>» Fotografi.</li> <li>» Analiza e punimeve të nxënësve.</li> <li>» Vështrimi i aspekteve pozitive dhe negative nga ndryshimi ditari hulumtues.</li> </ul>
<p>Pas përfundimit të aksionit</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Suksesi i nxënësve para dhënies së serisë së informatave kthyese.</li> <li>» Pyetësor për nxënësit.</li> <li>» Pyetësor për prindërit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Pyetësor për nxënësit.</li> <li>» Fleta e evaluimit.</li> <li>» Fotografite / videoshënimet.</li> <li>» Analiza e punimeve të nxënësve.</li> <li>» Test kreativiteti.</li> </ul>
<p>Hapi 7 - Planifikimi i kohës</p>	<p>Dy muaj e gjysmë.</p>	<p>Dy muaj një herë në javë.</p>

# STUDIMI I RASTIT



**Studimi i rastit është metodë e hulumtimit empirik e një dukurie aktuale (rast) në kontekst real kur kufinj të ndërmjet dukurisë dhe kontekstit nuk janë të qarta dhe shfrytëzohen burime të ndryshme të informatave.**

(Sipas Yin 1984)

**S**tudimi i rastit paraqet lloj të hulumtimit kualitativ që e realizojnë kur kemi për qëllim që ta zbulojmë kuptimin e ndonjë dukurie ose ngjarje: ti hulumtojmë proceset ; të fitojmë qasje të brendshme dhe kuptim më të thellësishëm të njësisë; grupit ose situatës; të japim pasqyrë të kompletuar "të gjallë" për diçka që gjatë ndonjë intervenimi ka ndodhur dhe sqarim pse ka ndodhur ajo. Në këtë kontekst, me rast nënkuptojmë person, grup më të vogël ose më të madh (familje, paralele, shkollë, moshatarë...).

Qëllimi i këtij lloji të hulumtimit është hulumtimi i një numri të vogël të rasteve (më së shpeshti vetëm një), por hulumtimi është intensiv dhe në rrethana/ situata reale. Përfundimet nga studimi i rastit kanë të bëjnë vetëm me rastin konkret dhe në kontekstin konkret. Si metoda hulumtuese më së shpeshti shfrytëzohen metodat kualitative (intervistë, observim), por shfrytëzohen edhe metoda kuantitative (pyetësorë, teste...).



## Karakteristikat e studimit të rastit

Studimi i rastit:

- Përqëndrohet në një ose në disa manifestime të dukurisë.
- Realizohet në mjedis natyrorë, në kushte reale dhe gjatë një peridhe të caktuar.
- Eksiston raport dinamik dhe interaktiv ndërmjet hulumtuesit dhe pjesëmarrësve në hulumtim.
- Hulumtuesi mundet, por nuk është e thënë që të jetë edhe pjesëmarrës në studimin e rastit.
- Theksi është i dhënë në të kuptuarit e thellë të rasteve specifike.
- Kujdeset për raportin e ndërsjellë të të gjitha ndryshoreve me qëllim të përshkrimit gjithëpërfshirës dhe të kuptohet dukuria ose ndryshimi i kyçur.
- I përgjigjet pyetjes PSE dhe SI (në vend se ÇKA dhe SA).
- Jep përshkrim të detajuar, interpretim dhe sqarim.

- Shfrytëzohen burime të ndryshme të informatave dhe të dhëna të ndryshme (kuantitative dhe kualitative, objektive – subjektive).
- Monstra e të pyeturve është e qëllimshme (nuk është e rastësishme)..

Specifike për studimin e rastit është ajo se nuk mund të manipulohet me sjelljen e atyre që janë të kyçur në studim, hulumtuesi ka pak kontrollë mbi ngjarjet. Kufijtë ndërmjet dukurisë dhe kontestit nuk janë shumë të qarta, ndërsa kontesti merret parasysh për atë se konsiderojmë se është shumë relevant. Problemi i cili hulumtohet në studimin e rastit kërkon të kuptuarit holistik dhe mund të sqarohet duke shfrytëzuar përfundim induktiv – nga rasti i individual deri në gjeneralizim.



### Llojet e studimeve të rastit

Sipas qëllimeve hulumtuese studimet e rastit mund të jenë:

<b>Sqaruese</b>	Shfrytëzohen të gjendet përgjigje për lidhjet shkak – pasojë në inetrvenimet në jetën reale të cilat janë për së tepermi komplekse për hulumtimet tjera ose janë aq unikate saqë nuk mund të përgjithësohen.
<b>Hulumtuese</b>	Shfrytëzohen që të hulumtohet ndonjë situatë e caktuar para se të bëhet hulumtim në përmasa më të mëdhaja për tu identifikuar pyetjes të cilat më vonë do të hulumtohen ose në mënyrë të detajuar të hulumtohet situatë ku evaluimi i intervenimit të ndërmarë nuk ka treguar rezultate evidente.
<b>Përshkruese</b>	Shfrytëzohen për tu përshkruar ndonjë dukuri / intervenim në kontekst real. Shërben për diçka që nuk është aq e njohur për ta afruar deri të lexuesit dhe të ndikojnë për të kuptuarit e baraspeshuar të dukurisë.

Sipas përfshirjes:

<b>Më shumë raste</b>	Hulumtimi i ndryshimeve në dhe ndërmjet shumë rasteve. Qëllimi është që të realizohen aspekte të njejta në raste të ndryshme.
<b>Një rast</b>	Испитување и опишување на определен случај што по многу нешта е уникатен.

(Sipas Yin 2003)



Përparësitë e studimit të rastit

- Fleksibiliteti – në krahasim me llojet e tjera të hulumtimeve, hulumtuesi ka liri më të madhe që dukurinë ta hulumton ashtu siç rrjedh ajo.

- Përshkruan situatë reale.
- Tregon dukurinë me tërë kokpleksivitetin e saj.
- Mund të tregon dukuri unike të cilat në hulumtimet tjera humben.
- Është "në hap nga aksioni" dhe mundet në mënyrë direkte të shfrytëzohet përvoja ose të sqarohet rasti i ngjashëm.
- Mund ta realizon edhe një hulumtues.
- Prezantohet në mënyrë interesante, lehtë "lexohet" që është i kuptueshëm për publikun më të gjërë.



### **Mangësitë e studimit të rastit**

- Studimi i rastit nuk përsëritet.
- Të dhënat mundet me qenë subjektive të anueshme, selektive në realitet ju mungon rigorizitet dhe besueshmëri shkencore.
- Njohuritë nuk mund të përgjithësohen.
- Ndonjëherë zgjasin gjatë.

Studimi i rastit, sikurse edhe çdo hulumtim tjetër, duhet të realizohet në mënyrë sistematike dhe kritike. Sikurse edhe tek llojet e tjera të hulumtimeve aksionale, për realizim më të lehtë duhet patur parasysh se nëpër cilat faza realizohet. Gjatë tërë kohës duhet pasur kujdes për validitetin dhe reliabilitetin si dhe për etikën në dhënien e të dhënave.



# FAZAT DHE HAPAT TE STUDIMI I RASTIT

## **Faza 1** DEFINIMI I LËNDËS SË STUDIMIT TË RASTIT DHE I PYETJES HULUMTUESE



### **Hapi 1 - Identifikimi i problemit**

- » Caktoni cili është problemi që doni ta hulumtoni.
- » Parashtroni pyetje në lidhje me të nga lloji: Si? Pse? Çka?

### **Shembull**

#### **A dëshironi ta plotësoni inkluzivitetin e shkollës tuaj**

Pyejte të cilat ju parashtrihen mund të jenë:

- Si do ta organizoni krejt procesin?
- Pse është me rëndësi që ti kyçni edhe prindët?
- Çka do të bëjmë me NN, i cili ka pengesa të kombinuara?



### **Hapi 2 - Formulimi i pyetjes hulumtuese**

- Nga numri më i madh i pyetjeve, caktoni një që do të jetë në fokusin e interesimit.
- Parashtroni supozim në lidhje me pyetjen tuaj hulumtuese (në rast se është relevante).
- Caktoni se çka do të keni njësi për analizë, e çka jo. Ajo mundet me qenë programë e caktuar, proces, dallime ndërmjet shkollave, etj).
- Mendoni se cilat raporte mund të eksistojnë në lidhje me ate që dëshironi të shfrytëzoni. Shfrytëzoni dituritë nga hulumtimet e mëparshme, teoritë dhe përvojat.
- Rastin të cilin do ta hulumtoni, kufizoni me kohë, hapësirë, aktivitet, përkufizim dhe kontekst. Mund të jetë e dobishme nëse bisedoni me kolegët.
- Përkufizoni pyetjen tuaj hulumtuese.



## Shembull

Shembull i rastit	Pyetje hulumtuese
1. Përvetësimi i qasjeve të reja në mësimin e gjuhës të më të riturit / arsimtarët me përvojë.	Si arsimtarët më të moshuar / me përvojë vendosin se a do ti shfrytëzojnë qasjet e reja? Cilat faktorë ndikojnë në vendimet e tyre?
2. Përvojat e arsimtarëve, më të moshuar në mësimin klasor me qasjet e reja në mësimin nga gjuha.	Si janë përvojat e arsimtarëve më të moshuar nga mësimi klasorë me ndryshimet? A ndikojnë ata përvoja në pranimin e ndryshimeve nga ana e tyre?
3. Vendosshmëria për përvetësimin e ndryshimeve në mësimin nga gjuha të arsimtarët klasor më të moshuar nga shkollat "elite".	Si e përshkruajnë marrjen e vendimeve në lidhje me shfrytëzimin e qasjeve të reja në mësim nga gjuha arsimtarët më të moshuar të mësimin klasorë nga shkollat e ndryshme "elite"?

Në rastin e parë. Theksi është vendosur në sjelljen e vendimeve dhe atë e hulumtoni dhe përshkruani te numri më i madh i arsimtarëve të moshuar; në rastin e dytë, theksi është në përvojat e një numri të caktuar të arsimtarëve të moshuar ndërsa në rastin e tretë, theksi është në shkollat "elite".

Ndonjëherë është e dobishme që të parashtroni supozim në lidhje me pyetjen hulumtuese. Supozimin e bëni në bazë të njohjes së proceseve dhe gjendjes dhe në bazë të teorisë. Supozimi do t'ju ndihmon që ta specifikoni pyetjen hulumtuese. Në shembujt më lartë supozimi është se arsimtarët më të moshuar / me më shumë përvojë sillen në mënyrë të ndryshme ndaj pranimin të ndryshimeve se sa ata më me pak përvojë.

Caktimin e më të moshuarve/ më me përvojë/ duhet ta specifikoni në raport me atë se kush hyn në atë kategori, në cilën periudhë të përvojës së tyre ka të bën studimi, në cilat ndryshime të mësimin nga gjuha ka të bën.

## Faza 2 PLANIFIKIMI I HULUMTIMIT



### Hapi 3 - Caktimi i të dhënave që do të grumbullohen

Që më parë caktohet se çfarë të dhënash është me rëndësi të grumbullohen – në pëlqim me pyetjen hulumtuese. Zakonisht të dhënat janë kualitative por mund të mblidhen edhe të dhëna kuantitative, gjatë së cilës mund në mënyrë të ndërsjelltë mund të plotësohen.

- Planifikoni se si do të siguronit relijabilitet të të dhënave (si do ti kontrolloni). Planifikoni triangulacion. Objektiviteti i të dhënave kalitative mund të zmadhohet me: numër më të madh të personave që intervistohen dhe me definim preciz dhe të qartë të kategorive.
- Caktoni se çka do të keni burim të informatave (cilat dokumente, persona, burime të tjera).
- Në rast se është e nevojshme (kur nuk punohet vetëm për një subjekt), caktoni mostrën e hulumtimit. Mostra duhet të jetë e vogël, zakonisht është i përshtatshëm ose i qëllimshëm dhe duhet të jetë reprezentativ për teorinë (supozimin), e jo për popullacionin..

**Shembull:** Nëse teoria thotë se personat që janë ritur në familje me dhunë më së shpeshti do të jenë të dhunshëm në raport me ata të cilët nuk kanë përjetuar dhunë në familje, atëherë në studimin e rastit për veprimin me dhunën në një shkollë si mostër për studim do ti zgjedhim personat nga grupi i parë.



### Hapi 4 - Planifikimi i resurseve dhe i kohës

Planifikimi i resurseve dhe i kohës është me rëndësi, në rast se nuk është në pyetje vetëm një rast në të cilin vetë realizoni ndryshime.

- Planifikoni kush do të angazhohet në grumbullimin e të dhënave.
- Cilat instrumente për grumbullimin e të dhënave duhet ti përgatitni.
- A duhet ti trajtoni ata që do të grumbullojnë të dhëna.
- Kur dhe cilat të dhëna do të grumbullohen dhe do të përpunohen.
- Planifikoni se në cilën mënyrë do ti arkivoni (videoshënime, fotografi, protokole për shënime, sistematizime).
- Parashikoni barrierat e mundshme (mosqasja në të dhëna, të dhëna joadekuate etj.), reaksione në situata të paprtitura. Qëndroni të hapur për të redizjuar planin fillestarë.

## Faza 3 СПРОВЕДУВАЊЕ НА ИСТРАЖУВАЊЕТО



### Hapi 5 - Krijimi i instrumenteve

Përpunoni instrumentet për grumbullimin e të dhënave. Zakonsiht ata janë protokole për udhëheqjen e intervistave dhe protokole për analiza të dokumentacionit. Ashtu do të siguroni që ti keni të gjitha të dhënat që janë të nevojshme (që mos ketë nevojë përsëri që të ktheheni në burime të njejta).



### Hapi 6 - Grumbullimi i të dhënave

- Duhe të jeni sistematik në grumbullimin e të dhënave.
- Burimet e të dhënave mundet ti keni të ndryshme:
  - » Lloje të ndryshme të intervistave me personin;
  - » Intervistë me persona të tretë – anëtarë të familjes, shokë të personit që pyetet;
  - » Vëzhgimi i sjelljes spontanë i sjelljes së personit që pyetet;
  - » Vëzhgimi i personit që pyetet në test situata të standardizuara;
  - » Analiza e punimeve të personit që pyetet;
  - » Analizë e dokumentacionit tjetër (portfolio, raporte..).
- Kujdesuni gjithmonë që të jetë i qartë burimi i informatave për të mundur të thireni në ta.
- Shënoni nëse keni bërë ndryshime në planin e grumbullimit të informatave.

## Faza 4 PËRPUNIMI I TË DHËNAVE DHE PREZANTIMI I REZULTATEVE



### Hapi 7 - Analiza dhe interpretimi i rezultateve

Në studimin e rasteve zakonisht sigurohen të dhëna të shumta të llojllojshme. Bëni seleksionimin e atyre të dhënave të cilat janë me të vërtetë të rëndësishme..

- Mund të shfrytëzoni qasje të ndryshme për analizë dhe interpretim:
  - » Lidhshmëri me supozimet;
  - » Gjetje të sqarimeve;
  - » Analizë e periudhave kohore;
  - » Modele logjike;
  - » Krahasim ndërmjet rasteve.
- Në rast se ndodh të dhënat mos jenë konzistente, ndoshta do të ketë nevojë për kontrollim ose grumbullim të të dhënave plotësuese.
- Kyçni kodim të dyfishtë të të dhënave për tu siguruar se nuk i keni komentuar në mënyrë subjektive.
- Kontrolloni interpretimin me pjesëmarrësit.
- Mirë është të shfrytëzoni paraqitje grafike të të dhënave..



### Hapi 7 - Prezantimi

„Studimi i rastit në mënyrë gjenerale është tregim në të cilin takohemi me të treguar narativ të ngjarjeve aktuale ose reale ku ka thurje, ekspozicion, personazhe dhe ndonjëherë dialog ndërmjet tyre. Gjeneralisht, studimet e rastit pikërisht janë deskriptive, gjatë së cilave problematika kryesore më së shpejti definohet si kombinim i përshkrimit dhe analizës” (Boehrer 1990).

- Përshkruani kontestin dhe dukurinë - rastin.
- Raporti mundet me qenë kronologjik, komparativ ose sipas supozimeve.
- Ai duhet të jetë konçiz dhe në format të lexueshëm lehtë.



## SI DUKET RAPORTI I STUDIMIT TË RASTIT?

Qëllimi i raportit është që ta përshkruan hulumtimin në mënyrë gjithëpërfshirëse për ti mundësuar lexuesit që të ndjehet si pjesëmarrës aktiv në vet hulumtimin dhe ti ndihmon në situatë të caktuar të mundet ti zbaton rrezultatet e hulumtimit. Studimet e rastit janë fleksibile dhe ata mundet të prezantohen në shumë mënyra, pa ekzistuar format i caktuar që duhet të ndiqet.

Raporti duhet të jetë i shkruar analitiksiht, i ilustruar me shembuj dhe të jetë i lidhur mirë me teorinë

**Struktura e raportit** për studimin e rastit mund me qenë me sa vijon:

### Hyrja dhe arsyetimi

- Pse kjo pyetje është me rëndësi për mua ?
- Cila janë qëllimet e këtij studimi?
- Cili është konteksti i këtij studimi?

### Metodologjia

- Si zhvillohej procesi? (Përshkrimi asaj se është zgjedhur vetë rasti dhe i burimeve për hulumtim).
- Çfarë supozimesh ekzistojnë?(Nëse ekzistojnë)
- Në çfarë mënyre janë grumbulluar informatat?
- Çfarë mostrash shfrytëzohen në hulumtim?
- Në Çfarë periudhe kohore janë grumubulluar informatat?
- Cila metodë është shfrytëzuar dhe a ekzistojnë kufizime të caktuara në këtë metodë?

### Përshkrimi i problemit dhe i intervenimeve

- Pjesa narrative në të cilin në detaje përshkruhet problemi.
- Si është studjuar problemi?
- Cilat inetrvenime janë kryer – përshkrimi i tyre.

### Sfidat

- Cilat janë sfidat?
- Si i caktuam?

## Rezultatet

- Çka është fituar?
- Cilat janë dobitë?
- Çka është ajo që duhet të punohet edhe më tutje?

## Leksioni i mësuar

- Çka mësova?
- Çka do të bëj më tutje?
- Informatat që i fitova si mundet të jenë të dobishme për të tjerët?

**Përfundimi** - *Rezyme e shkurtër e studimit.*

**Shtojca** - *Fakte për ate çka është treguar në raport (fotografi, punime nxënësish, skema...).*

**Shembuj të raporteve nga studimet e rastit** (janë shfrytëzuar studime të rastit nga publikimet Inclusive education in Macedonia, Five case studies from schools involved in UNICEF's inclusive education, training-of-trainers program, 2012–2014)

	Studimi përshkrues	Studimi i një rasti
Emri i studimit	<i>Formimi i shkollës më inkluzive</i>	<i>Përkrahja e pjesëmarrjes dhe të ariturave: rëndësia e bashkëpunimit</i>
Hyrja dhe arsyetimi	Me këtë studim rasti është përshkruar procesi i inkluzionit në një shkollë fillore. Me ndihmën e projektit për arsim inkluziv të UNICEFIT it, nxënësit, arsimtarët dhe bashkëpunëtorët profesional kanë bërë lëvizje nga arsimi i integruar në arsim inkluziv.	Me këtë studim të rastit është treguar se si shkolla implementon praktikën inkluzive të të gjithë nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Është ilustruar praktikë e mirë me shpresë se do t'ju ndihmon edhe arsimtarëve të tjerë të kyçin ndryshime në praktikën e tyre.





## Metodologjia

- » Rasti është zgjedhur duke u nisur nga dëshira e arsimtarit që ta praktikon inkluzionin jo vetëm në nivel të klasës së tij por edhe në nivel të shkollës. Në fillim ka pasur tentime të pavarura për inkluzion, shpërndarje të përvojave të arsimtarëve ndërmjet vetes, konsultime me shërbimet profesionale. Informatat e fituara kanë qenë të mangëta dhe pa efekte të medha gjatë zbatimit.
- » Supozimet kanë qenë se edhe pse nuk ekzistojnë resurse të mjaftueshme, me trajnim të kuadrit inkluzioni mund të bëhet praktikë.
- » Informatat për të ariturat është planifikuar që të merren nëpërmjet deklaratave të prindërve, arsimtarëve dhe nxënësve, vëzhgim, konstatim të ndryshimeve në qasje.
- » është punuar me grupe të arsimtarëve, nxënësve dhe prindërve.
- » Studimi ka të bëjë për periudhën prej dy viteve shkollore.
- » Aktivitete zhvillohen nëpërmjet punëtorive, diskutimeve, këshillimeve. Vështirësi dhe kufizime paraqiten kur disa arsimtarë kufizojnë format e këtilla të kyçjes.
- » Është treguar rasti i fëmijut me pengesa, i cili është dashur të regjistrohet në shkollë vitin e ardhshëm shkollorë. Prindi është kyçur në punëtori në korniza të Qendrës për resurse të prindërve në këtë shkollë, i përkrahur nga Projekti për arsim inkluziv të UNICEF -it.
- » Është detektuar lloji i vështirësisë dhe supozimi ka qenë se fëmiju mund të përgatitet para ardhjes në shkollë me ndihmën e më tepër personave profesional.
- » Informatat për të ariturat, planifikohet që të fitohen nëpërmjet deklaratave të prindërve, vëzhgim, raport nga personat profesional defektolog dhe logoped.
- » Është punuar me fëmijun në mënyrë individuale dy herë në javë me defektolog dhe tre herë në javë me logoped.
- » Studimi ka të bëjë për periudhën pesë mujore Maj - Shtator
- » Aktivitetet e ekipit për inkluzion kanë të bëjnë me detektimin, ndjekjen ndryshimeve dhe këshillimin e prindit për hapat që duhet të ndërmerren për ta përgatitur fëmijun për fillim të shkollimit



<p><b>Përshkrimi i problemit dhe hapat nëpërmjet të cilave është hulumtuar</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Inkluzioni promovohet në nivel shkollorë</li> <li>» Është formuar ekipi për inkluzion.</li> <li>» Janë realizuar trajnime për arsimtarët.</li> <li>» Janë shpërnadrë materiale, literatura, instrumente të krijuara.</li> <li>» Është kryer sensibilizimi i nxënësve, arsimatrëve dhe prindërve nëpërmjet punëtorive, diskutimeve, përkrahje, këshillime</li> <li>» Në detaje janë përshkruar proceset e sensibilizimit dhe vështirësitë e hasura.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Problemi është se si të përgatitet fëmiju (i cili nuk flet, nuk kontakton me sy , është i shqetësuar) për fillimin e shkollimit dhe si të përgatitet mjedisi shkollorë dhe paralelja për përkrahje që duhet ti jepet.</li> <li>» Në muajin Maj prindi është udhëzuar në institucionet ku mund ti jepet ndihmë dhe përkrahje përkatëse fëmijut.</li> <li>» Në muajin Shtator është punuar në sensibilizimin e paraleles.</li> <li>» Të dy proceset janë përshkruar detajisht.</li> </ul>
<p><b>Sfidat</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Pjesëmarrja dhe të arriturat te të gjithë nxënësit.</li> <li>» Përfshierja e të gjithë arsimtarëve dhe praktikimi i arsimit inkluziv.</li> <li>» Informimi, këshillimi dhe kyçja e prindërve në aktivitete.</li> <li>» Procesi inkluziv në tërë shkollën në kontinuitet.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Përmirësimi i procesit të shkrim leximit.</li> <li>» Të mësuarit e respektimit të rregullave.</li> </ul>
<p><b>Rezultatet</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Janë detektuar nevojat e veçanta arsimore te nxënësit dhe për ta janë përgatitur programe individuale.</li> <li>» Arsimtarët zhvillojnë dhe praktikojnë shkathtësi për qasje inkluzive .</li> <li>» Ende ka arsimtarë që refuzojnë të kyçen në procesin e inkluzionit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Socializimi dhe komunikimi i nxënësit me nxënësit e tjerë dhe arsimtarin.</li> <li>» Numëron, dallon ngjyrat, format, realcionet dhe shkronjat.</li> <li>» Vetëbesim më i madh te fëmiju.</li> <li>» Përkrahja e prindit .</li> </ul>
<p><b>Leksioni i mësuar</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Të krijohet mjedis inkluziv, do të thotë të rënohen barrierat dhe të investohet në një qasje sistematike.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Gjithçka që bëhet me nxënësit me nevoja të veçanta duhet të jet ë e aftësuar pikërisht në kërkesat e tyre dhe në kontekst. Vetëm qasja e tillë mund të jep zhvillim.</li> </ul>





---

**Përfundimi**

Çdo nxënës ndonjëherë ka nevojë për kujdes dhe përkrahje të veçantë. Arsimi inkluziv është rruga e vetme që shpjen drejt shoqërisë inkluzive, ndërsa inkluzioni nuk mund të ndodh pa qasje sistematike.

Planifikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet shkollës, prindit dhe institucioneve profesionale jashtë shkollës bënë ndryshime pozitive dhe ndihmuan nxënësin M. M. të tregon përparim të madh.

---

## LITERATURA

1. *Action Research Guide for Alberta Teachers*, (2000), Alberta Teachers' Association, <http://www.teachers.ab.ca/SiteCollectionDocuments/ATA/Publications/Professional-Development/ActionResearch.pdf>
2. Baxter P., S. Jack, *Qualitative Case Study Methodology: Study Design and Implementation for Novice Researchers*, The Qualitative Report Volume 13 Number 4 December 2008 544-559, <http://www.nova.edu/ssss/QR/QR13-4/baxter.pdf>
3. Bognar B., *Akcijska istraživanja u školi*, Odgojne znanosti, Vol. 8 No. 1(11) Lipanj 2006, <http://hrcak.srce.hr/26189>
4. Bruce Ferguson P., (2001), *Action Research for Professional Development*, The University of Waikato, [http://www.waikato.ac.nz/tdu/pdf/booklets/24\\_AR.pdf](http://www.waikato.ac.nz/tdu/pdf/booklets/24_AR.pdf)
5. *Case Studies*, Colorado State University, <http://writing.colostate.edu/guides/guide.cfm?guideid=60>
6. *Case Studies*, UNICEF - Macedonia, [http://www.unicef.org/tfymacedonia/Inkluzivno\\_obazovanie\\_-\\_mk\(2\).pdf](http://www.unicef.org/tfymacedonia/Inkluzivno_obazovanie_-_mk(2).pdf) [http://www.unicef.org/tfymacedonia/JAZICNA\\_PISMENOST\\_Lan\\_Report\\_2010\\_MKD\\_za\\_na\\_web.pdf](http://www.unicef.org/tfymacedonia/JAZICNA_PISMENOST_Lan_Report_2010_MKD_za_na_web.pdf), [http://www.unicef.org/tfymacedonia/UNICEF\\_Math\\_Report\\_2012\\_-MK\\_za\\_web\\_so\\_korica.pdf](http://www.unicef.org/tfymacedonia/UNICEF_Math_Report_2012_-MK_za_web_so_korica.pdf)
7. Cohen L., L. Manion, K. Morison (2007), *Research Methods in Education*, Routledge.
8. Ferrance E., (2000), *Action Research*, Northeast and Islands Regional Educational Laboratory At Brown University, [http://www.brown.edu/academics/education-alliance/sites/brown.edu/academics/education-lliance/files/publications/act\\_research.pdf](http://www.brown.edu/academics/education-alliance/sites/brown.edu/academics/education-lliance/files/publications/act_research.pdf)
9. Kovačević D., R. Ozorlić Dominić (2011), *Akcijsko istraživanje i profesionalni razvoj učitelja i nastavnika*, Agencija za odgoj i obrazovanje, Zagreb.
10. Neale, P. S. Tapa, C. Boyce, (2006), *Preparing a Case Study: A Guide for Designing and Conducting a Case Study for Evaluation Input*, Pathfinder International, <http://www.pathfinder.org/publications-tools/pdfs/Preparing-a-Case-Study-A-Guide-for-Designing-and-Conducting-a-Case-Study-for-Evaluation-Input.pdf>
11. Смилевски Ц. (2006), *Методологија на истражувања*, Универзитет „Св. Климент Охридски“, Битола.
12. Teachers Network Leadership Institute, *How to do Action Research in Your Classroom*, [https://www.naeyc.org/files/naeyc/Action\\_Research\\_Booklet.pdf](https://www.naeyc.org/files/naeyc/Action_Research_Booklet.pdf)
13. Tran Thi Thu Hien, *Why is action research suitable for education?*, VNU Journal of Science, Foreign Languages 25 (2009) 97-106, [http://js.vnu.edu.vn/nn\\_2\\_09/b4.pdf](http://js.vnu.edu.vn/nn_2_09/b4.pdf)

## Shtojca 1: Shembull i planit për hulumtim aksional

### Pyetje hulumtuese:

A mundet nëpërmjet të zbatimit të ushtrimeve të teknikave për paraqitje me vizatime (hartave mendore) të përmirësohet të lexuarit dhe të kuptuarit e detyrave tekstuale te nxënësit e klasës IV - 2 ?

Aktiviteti	Koha	Përshkrimi i aktivitetit	Kush është i kyçur
Përgatitja e materialit për punë	27-29.04.2015	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Zgjedhje e detyrave tekstuale</li> <li>» Ndarja në bazë të niveleve të komplikueshmërisë</li> <li>» Zgjidhja me organizim të të dhënave me ndihmën e hartave mendore</li> </ul>	Bashkëpunëtor profesional, arsimtar
Grumbullimi i të dhënave fillestare	5.05.2015	» Fletë pune nr. 1 me 4 – 5 detyra tekstuale sipas nivelit të 3 të ndërlikueshmërisë	Bashkëpunëtor profesional, arsimtar
	8.05.2015	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Pyetësor për nxënësit me 4 pyetje të hapura</li> <li>» Pyetësor për arsimtar</li> </ul>	
Hyrja në ushtrime	11.05.2015	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Fjalët kyçe në të cilat duhet patur kujdes në zgjidhjen e detyrave tekstuale</li> <li>» Çka është organizimi i të dhënave me ndihmën e hartave mendore</li> <li>» Si rrjedh procedura e organizimit të të dhënave</li> </ul> <p><b>Shembulli 1:</b> Zgjidhja e detyrave tekstuale – niveli 1 me ndihmën e hartës mendore</p> <p><b>Ushtrimi 1:</b> Zgjidhja e detyrave tekstuale</p>	Bashkëpunëtor profesional, arsimtar
Aktivitet-Ushtrime	12.05.2015	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Rikujtimi i shembullit 1</li> </ul> <p><b>Ushtrimi 2:</b> Zgjidhja e detyrave tekstuale – niveli 1 me ndihmën e hartës mendore</p>	Arsimtar, nxënës
Aktivitet-Ushtrime	13.05.2015	<p><b>Ushtrimi 3:</b> Zgjidhja e detyrave tekstuale – niveli 1 me ndihmën e hartës mendore</p>	Nxënës

...→

Aktivitet-Ushtrime	14.05.2015	<b>Shembulli 2:</b> Zgjidhja e detyrave tekstuale – niveli 2 me ndihmën e hartës mendore <b>Ushtrimi 4:</b> Zgjidhja e detyrave tekstuale – niveli 2 me ndihmën e hartës mendore	Bashkëpunëtor profesional, nxënës
Aktivitet-Ushtrime	15.05.2015	» Rikujtimi i shembullit 2 <b>Shembulli 3:</b> Zgjidhja e detyrave tekstuale – niveli 2 me ndihmën e hartës mendore <b>Ushtrimi 5:</b> Zgjidhja e detyrave tekstuale – niveli 2 me ndihmën e hartës mendore	Bashkëpunëtor profesional, arsimtar, nxënës
Aktivitet-Ushtrime	18.05.2015	» Rikujtimi i shembullit 3 <b>Ushtrimi 6:</b> Zgjidhja e detyrave tekstuale – niveli 2 me ndihmën e hartës mendore	Arsimtar, nxënës
Aktivitet-Ushtrime	19.05.2015	<b>Ushtrimi 7:</b> Zgjidhja e detyrave tekstuale – niveli 2 me ndihmën e hartës mendore	Nxënës
Aktivitet-Ushtrime	20.05.2015	<b>Shembulli 4:</b> Zgjidhja e detyrave tekstuale – niveli 3 me ndihmën e hartës mendore <b>Ushtrimi 8:</b> Zgjidhja e detyrave tekstuale – niveli 3 me ndihmën e hartës mendore	Bashkëpunëtor profesional, arsimtar, nxënës
Aktivitet-Ushtrime	21.05.2015	<b>Ushtrimi 9:</b> Zgjidhja e detyrave tekstuale – niveli 3 me ndihmën e hartës mendore	Nxënës
Grumbullimi i të dhënave pas ushtrimit	22.05.2015	» Fletë pune nr. 2 me 4 – 5 detyra tekstuale sipas nivelit të 3 të ndërlikueshmërisë	Bashkëpunëtor profesional, arsimtar
	26.05.2015	» Pyetësor për nxënësit me 4 pyetje të hapura » Pyetësor për arsimtar	

...→

...→

---

Analiza e të  
dhënave

- » Krahasimi i rezultateve të fitura në fillim dhe në fund të ushtrimit (F.P.1 dhe F.P.)
  - » Analiza e pyetësorëve para dhe pas ushtrimit
  - » Analiza e punimeve të nxënësve gjatë kohës së ushtrimeve
  - » Të dhëna nga ditari i hulumtimit në raport me ndjekjen dhe vëzhgimin e procesit
- 

Bashkëpunëtor  
profesional,  
arsimtar

Përgatitja e  
raportit

Bashkëpunëtor  
profesional,  
arsimtar

---

**Resurset e nevojshme:** Përmbledhje detyrash nga matematika, letër

**Mostër:** Nxënës nga klasa e IV- 2 – 15

Andijana Tasevska – psikolog

Anita Matevska – arsimtar klasor

SHFK „Krumë Kepeski“, Skopje

## Shtojca 2: Plan për studimi i rastit

### Pyetje hulumtuese:

nëse udhëzim të veçantë dhe mbështetje për zbatimin e parimeve nga mendo matematikisht në mësimin klasorë ndikon në të ariturat nga matematika te nxënësi me POP nga klasa e V?

Aktiviteti	Koha	Përshkrimi i aktivitetit	Kush është i kyçur
Përgatitja e materialit për punë	25-27.04.2015	<ul style="list-style-type: none"><li>» Hulumtim i bazimit teorik</li><li>» Definimi i indikatorëve të efekteve</li><li>» Pyetësor për nxënëse</li><li>» Organizimi i përmbajtjes për mësim – zgjedhje të detyrave</li><li>» Shpërndarja e drejtimeve të përkrahjes</li><li>» Zgjedhja e resurseve për punë</li></ul>	Bashkëpunëtor profesional, arsimtar
Grumbullimi i të dhënave fillestare	28.04.2015 30.04.2015	<ul style="list-style-type: none"><li>» Grumbullimi i informatave amnestuese për nxënësen nga defektologu</li><li>» Mendimi i arsimtarit</li><li>» Shqyrtimi i IOP</li><li>» Intervistë me prindin</li><li>» Pyetësor për nxënësen me 7 pyetje nga lloji i mbyllur</li><li>» Shqyrtimi i portfolios së nxënëses nga matematika (teste dhe detyra kontrolluese nga matematika)</li><li>» Të arriturat nga testi i matematikës në të cilin janë kyçur detyra që matin dituri konceptuale dhe procedurale, të kuptuarit dhe zbatimin e numrave natyrorë, 4 operacionet themelore dhe vetitë e tyre, si dhe zgjidhja e detyrave dhe problemeve tekstuale</li></ul>	Bashkëpunëtor profesional, arsimtar, defektolog, prind



...→

Analiza e të dhënave fillestare dhe përgatitja e planit për intervenim	4 -6.05.2015	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Vlerësimi i gjendjes momentare të nxënëses:</li> <li>» Anët e forta të nxënëses</li> <li>» Përshtatjet e nevojshme</li> <li>» Kahjet për punë</li> <li>» Analiza e testeve dhe detyrave kontrolluese nga matematika (nga gjysmëvjetori i parë dhe tremujori i tretë nga viti shkollorë 2014/2015) – përqindja e përgjithshme e detyrave të zgjidhura saktë dhe përqindja e detyrave të zgjidhura tekstuale</li> <li>» Analiza deskriptive e gjykimeve të arsimtares dhe defektologut për të arriturat e nxënëses në matematikë</li> <li>» Analizë deskriptive e të dhënave për interesimin dhe mënyrën e punës së nxënëses në shkollë dhe në kushtë shtëpiake</li> <li>» Përgatitja e planit për vizita në orë të rregullta nga matematika dhe mësimi plotësues</li> <li>» Fjalë kyçe - arimet nga Mendo matematikisht</li> </ul>	Bashkëpunëtor profesional
Realizimi i aktiviteteve Aktivitet-Ushtrime	6.05.2015	<p><b>Ushtrimi 1:</b> Motivimi dhe kyçja mendore e nxënëses.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>» Zhvillimi i ndjenjës për numër – zbërthimi dhe formimi i sërishëm i numrave për shkak të thjeshtësimit të njehsimit.</li> <li>» Ndjekja e frekuencës së ndihmës së kërkuar nga arsimtarja në zgjidhjen e detyrave</li> </ul>	Arsimtar, Nxënësja

...→

Aktivitet- Ushtrime	11.05.2015	<b>Ushtrimi 2:</b> Lidhshmëria e diturive » Zgjidhje të detyrave me zbatim të strategjive të ndryshme » Përdorimi i teknikave të të pyeturit që i mundëson nxënësës që qartë ta shpreh mendimin dhe gjykimin e vetë » Nxitja e përdorimit të teknikave për vlerësim » Ndjekja e frekuencës së ndihmës së kërkuar nga arsimtarja në zgjidhjen e detyrave	Arsimtar, Nxënësja
Aktivitet- Ushtrime	13.05.2015	<b>Ushtrimi 3:</b> Zgjidhja e problemeve dhe zbulimi i diturive » Zgjidhja e detyrave tekstuale – » Nxitja për ta shprehur të menduarit matematikorë » Formimi i problemeve të lidhura me përvojën e nxënësës » Baraspeshimi i të menduarit konceptual dhe procedural » Pranimi i zgjidhjeve të llojllojshme » Përmirësimet pozitive » Ndjekja e frekuencës së ndihmës së kërkuar nga arsimtarja në zgjidhjen e detyrave	Arsimtar, Nxënësja
Aktivitet- Ushtrime	14.05.2015	<b>Ushtrimi 4:</b> Zgjidhja e detyrës – të mësuarit nëpërmjet lojës	Arsimtar, Nxënësja
Aktivitet- Ushtrime	15.05.2015	» Rikujtim i detyrës nga ushtrimi 3 <b>Ushtrimi 5:</b> Riorganizimi i diturive » Zgjidhja e detyrave tekstuale – » Zbërthimi dhe formimi i sërishëm i pjesëve nga detyra » Zbatimi i teknologjisë asistive (ndihmëse) » Përdorimi i fakteve të mirënjohura për shkak të fituarit e fakteve të reja » Përmirësime pozitive » Ndjekja e frekuencës së ndihmës së kërkuar nga arsimtarja në zgjidhjen e detyrave	Arsimtar, Nxënësja





Aktivitet- Ushtrime	18.05.2015	<b>Ushtrimi 6:</b> Rishqyrtimi i diturive dhe propozimi i zgjidhjeve të reja <ul style="list-style-type: none"> <li>» Zgjidhja e detyrës duke përdorur strategji të ndryshme të të mësuarit</li> <li>» Shfrytëzimi i mjeteve konkretizuese</li> <li>» Përmirësim pozitiv</li> <li>» Ndjekja e frekuencës së ndihmës së kërkuar nga arsimtarja në zgjidhjen e detyrave</li> </ul>	Arsimtar, Nxënësja
Aktivitet- Ushtrime	19.05.2015	<b>Ushtrimi 7:</b> Zgjidhja e detyrave tekstuale – lidhshëmria ndërmjet paraqitjes konkrete dhe simbolike <ul style="list-style-type: none"> <li>» Zbatimi i teknologjisë asistive (ndihmëse)</li> <li>» Përmirësim pozitiv</li> <li>» Ndjekja e frekuencës së ndihmës së kërkuar nga arsimtarja në zgjidhjen e detyrave</li> </ul>	Arsimtar, Nxënësja
Aktivitet- Ushtrime	20.05.2015	<b>Ushtrimi 8:</b> Zgjidhja e detyrave të bazuara në aftësitë e tyre për lehtësimin e zhvillimit në nivele më të larta të të menduarit dhe shkathësive për të gjykuar <ul style="list-style-type: none"> <li>» Përmirësim pozitiv</li> <li>» Ndjekja e frekuencës së ndihmës së kërkuar nga arsimtarja në zgjidhjen e detyrave</li> </ul>	Arsimtar, Nxënësja
Aktivitet- Ushtrime	21.05.2015	<b>Ushtrimi 9:</b> Modelimi i punës intelektuale – zgjidhja e detyrave tekstuale. Përdorimi i fakteve të mirënjohura për të fituar fakte të reja <ul style="list-style-type: none"> <li>» Përqëndrimi në vlrësimin vizuel</li> <li>» Ndjekja e frekuencës së ndihmës së kërkuar nga arsimtarja në zgjidhjen e detyrave</li> </ul>	Arsimtar, Nxënësja



...→

Aktivitet- Ushtrime	22.05.2015	<b>Ushtrimi 10:</b> Zgjidhja e detyrave të bazuara në aftësitë e tyre për lehtësimin e zhvillimit në nivele më të larta të të menduarit dhe shkathësive për të gjykuar » Përmirësim pozitiv » Ndjekja e frekuencës së ndihmës së kërkuar nga arsimtarja në zgjidhjen e detyrave	Arsimtar, Nxënësja
Grumbullimi i të dhënave pas ushtrimit	22.05.2015	» Fleta pune (gjithësej 4) » Pyetësor për nxënësë me 7 pyetje të llojit të mbyllur	Bashkëpunëtor profesional, Arsimtar, Prind, Nxënësja
	26.05.2015	» Frekuentimi i ndihmës së kërkuar nga arsimtarja për zgjidhjen e detyrave në raport me numrin e orëve të vizituara » Gjykime nga arsimtari » Gjykime nga prindi	
Analiza e të dhënave	22.-28.05.2015	» Analiza e testeve të detyrave kontrolluese në këtë periudhë (4) – numri i saktë i detyrave të zgjidhura i shprehur në përqindje dhe përqindja e detyrave tekstuale të zgjidhura » Krahasimi i rezultateve të fituara në fillim dhe në fund të ndjekjes » Analiza e pyetësorëve të nxënësës para dhe pas ndjekjes » Të dhëna nga ditari hulumtues frekuentimi i ndihmës së kërkuar nga arsimtarja për zgjidhjen e detyrave në raport me numrin e orëve të vizituara » Gjykime nga arsimtari » Gjykime nga prindi	Bashkëpunëtor profesional, Arsimtar
Përgatitja e raportit	Deri 30.05.2015		Bashkëpunëtor profesional

**Resurset e nevojshme:** Përmbledhje detyrash nga matematika, letër, teknologji asistive, mjete konkretizuese

**Mostër:** nxënësja nga klasa e V-1

Lidija Haxhi Arsova - psikolog

SHFK „Vasil Gllavinov“, Veles

## Shtojca 3: Plan për hulumtim aksional

### Pyetje hulumtuese:

Pyetje hulumtuese: A do të ndikon zbatimi i teknikës Rrjeta e temës te nxënësit e klasës së pestë – a, në përmirësimin e të shkruarit të temës së lirë nga gjuha amtare?

Aktiviteti	Koha	Përshkrimi i aktivitetit	Kush është i kyçur
Përgatitja e materialit për punë	27-30.04.2015	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Përgatitja e pyetësorit për prindët, nxënësit dhe arsimtarin</li> <li>» Përgatitja e temave me shkrim të cilat kanë qenë të punuara më parë pa shfrytëzim të teknikës "rrejtji i temës" me qëllim që të bëhet analiza e të njejtës</li> </ul>	Bashkëpunëtor profesional, arsimtar
Realizimi i hulumtimit me pyetësor	07.05. 2015	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Takim me prindët, sqarimi i qëllimit të dhënies së pyetësorit dhe sqarim i pyetjeve të pyetësorit</li> <li>» Dhënia e pyetësorit nxënësve dhe ndihma dhe sqarime se si të plotësohet</li> <li>» Përkrahja e arsimtarit në plotësimin e pyetësorit</li> </ul>	Bashkëpunëtor profesional, arsimtar
Grumbullimi i të dhënave fillestare	08.05.2015.	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Analiza e përmbajtjeve me shkrim</li> <li>» Analiza e rrezultateve nga pyetësorët për nxënësit, prindët dhe arsimtarin, para shfrytëzimit të teknikës "rrejtji i temës"</li> </ul>	Bashkëpunëtor profesional, arsimtar

Hyrje në ushtrimin në orën e shoqërisë	11.05.2015	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Shfrytëzimi i teknikës "rrjeti i temës" në lëndët tjera mësimore (shoqëri) me qëllim që nxënësit të njihen më mirë me teknikën dhe mënyrën se si mundet ta shfrytëzojnë në mësim (ushtrime me shfrytëzim të teknikës)</li> <li>» Dhënia e kahjeve në çka duhet patur kujdes gjatë shfrytëzimi të teknikës</li> <li>» Çka do të thotë shfrytëzimi i teknikës "rrjeti i temës" në punë në orën mësimore</li> <li>» Si rrjedh procedura e zbatimit të teknikës</li> </ul> <p><b>Shembulli 1:</b> Zhvillimi i përmbajtjes së re mësimore me ndihmën e teknikës "rrjeti i temës"</p> <p><b>Ushtrimi 1:</b> Stuhi ideshë lidhur me titullin e përmbajtjes së re mësimore me ndihmën e teknikës</p> <p>Rikujtimi i shembullit 1</p> <p><b>Ushtrimi 2:</b> Përforcim i diturive për përmbajtjen e re mësimore me zbatim të teknikës "rrjeti i temës"</p>	Bashkëpunëtor profesional, arsimtar, nxënës
Aktivitet-ushtrime në orën e gjuhës shqipe	12.05.2015	<p><b>Shembulli 2:</b> Llojet e fjalive me zbatim të teknikës "rrjeti i temës"</p>	Arsimtar, nxënës
	15.05. 2015	<p><b>Ushtrimi 3.</b> Rikujtimi në shembullin 2 Të shënuarit e fjalive të plota (të thjeshta, të zgjeruara) me zbatim të teknikës "rrjeti i temës" (rikujtimi i shembullit 2)</p>	Arsimtar, nxënës
Aktivitet-ushtrime në orën e gjuhës shqipe	18.05.2015	<p><b>Shembulli 3:</b> Përshkrimi i mbiemrave - zbatimi i teknikës "rrjeti i temës"</p>	Arsimtar, nxënës
	20. 05. 2015	<p><b>Ushtrimi 4:</b> Të shënuarit e mbimerave përshkrues dhe fjalitë e plota me mbiemra përshkrues (rikujtimi i shembullit 3)</p>	Nxënës

...→

Aktivitet-ushtrime në orën e gjuhës shqipe	26.05.2015	<b>Shembulli 4:</b> Struktura e brendshme e përbajtjes së lirë me shfrytëzim të teknikës "rrjeti i temës" (rikujtimi në shembullin 2, 3 dhe 4).	Arsimtar, Nxënës
	05.06.2015	<b>Ushtrimi 5:</b> Të shkruarit e përbajtjes së lirë në temën: "Ku planifikoj ta kaloj pushimin veror" me zbatim të teknikës "rrjeti i temës" (rikujtim i shembullit 2, 3 dhe 4)	Arsimtar, Nxënës
Grumbullimi i të dhënave me zbatim të teknikës "Rrjeti i temës"	07.06.2015 deri 10.06.201	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Përbajtjet e lira të nxënësve të temave të cilat janë realizuar me zbatim të teknikës: "rrjeti i temës"</li> <li>» Pyetësi për prind, nxënës dhe pyetësi për arsimtar</li> </ul>	Bashkëpunëtor profesional, arsimtar
Analiza e të dhënave	10.06.2015 deri 30.06.2015	<ul style="list-style-type: none"> <li>» Analiza e përbajtjeve të lira të nxënësve para dhe pas zbatimit të teknikës "rrjeti i temës"</li> <li>» Krahasimi i rezultateve nga analizat e fituara të përbajtjeve para dhe pas zbatimit të teknikës "rrjeti i temës"</li> <li>» Analiza e pyetësorëve para dhe pas zbatimit të teknikës</li> <li>» Të dhëna nga ditari hulumtues në raport me ndjekjen dhe vëzhgimin e procesit</li> </ul>	Bashkëpunëtor profesional, arsimtar
Përgatitja e raportit	15.08.2015		Bashkëpunëtor profesional, arsimtar

**Resurse të nevojshme:** doracak për shkrim-lexim fillestar për klasat fillestare, libri i shoqërisë, libri i gjuhës shqipe

**Mostër:** Nxënës nga klasa e V-b – 33

Lidija Manusheva – psikolog

Tinka Abrasheva – arsimtar klasor

SHFK "Sando Masev", Strumicë





ISBN 978-608-206-047-7